
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

**Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ
Projekt i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

Raport për vlerësimin individual të gjyqtarëve në Shqipëri

Nga: Prof. Dr. Anne Sanders, M.Jur.¹

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Përkthimi i këtij dokumenti në gjuhën shqipe është bërë në kuadër e Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ”.

¹Profesore e Asociuar në Universitetin e Bonit, Gjermani.

I. Hyrje

1. Qëllimi i këtij raporti është të bëjë një analizë të sistemit aktual të vlerësimit individual të gjyqtarëve në Shqipëri kundrejt standardeve ndërkombëtare, veçanërisht standardeve të hartuara nga CCJE-ja në Opinionin e saj Nr. 17 (2014) “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësinë e drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë së gjyqësorit”. Raporti jep një përmbledhje të praktikës aktuale të vlerësimit individual të gjyqtarëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (II). Më pas, Raporti bën një përmbledhje të standardeve të CCJE (III). Më tej, Raporti përshkruan kuadrin aktual ligjor dhe praktikën e vlerësimit individual të gjyqtarëve në Shqipëri (IV). Më pas, raporti analizon dhe diskuton situatën aktuale lidhur me standardet e hartuara nga CCJE-ja (V). Së fundmi, raporti jep rekomandime për të përmirësuar situatën aktuale (VI).

II. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës

1. Materialet e përdorura

2. Pjesa e mëposhtme mbështetet tek Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për gjyqtarët: pavarësia, efica dhe përgjegjësitë (më poshtë Rekomandimi CM/Rec(2010)12); tek raporti i periudhës 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ) mbi standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mos-heqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit (më poshtë raporti i ENCJ-së),² Rekomandimet e Kievit të OSBE-së për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Juglindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore (2010) – administrata gjyqësore, përzgjedhja dhe llogaridhënia (më poshtë Rekomandimet e Kievit), dhe projektpërmbledhja e raportit të CCJE-së lidhur me pyetësorët e përgjigjur në përgatitje të Opinionit të CCJE-së dhe vetë Opinionit nr. 17 (2014) të CCJE-së.

2. Vlerësimi formal dhe informal

3. Raporti i ENCJ-së³ dhe Raporti 17 (2014)⁴ i CCJE-së bëjnë dallimin ndërmjet sistemit formal dhe informal të vlerësimit individual të gjyqtarëve. Nëse vlerësimi individual bëhet në mënyrë formale, përcaktohet qartësisht qëllimi i vlerësimit, kriteret e përdorura, përbërja dhe përgjegjësitë e organit vlerësues, si dhe pasojat e mundshme të vlerësimit, shpesh me anë të legjislacionit parësor. Në një sistem formal vlerësimi, zakonisht bëhet një klasifikim/renditje formale e gjyqtarëve. Për më tepër, vlerësimi ka shpesh pasoja të drejtpërdrejta, të tilla si mundësi më të mira për ngritje në detyrë, rritje të pagës, ose madje dhe shkarkim nga detyra. Sistemi i vlerësimit informal zakonisht nuk përdor as vlerësime/klasifikime dhe as kriteret formale. Zakonisht vlerësimi informal nuk ka pasoja të drejtpërdrejta, por shërben për të dhënë informacion rreth gjyqtarit objekt vlerësimi. Megjithatë, edhe mbledhja informale e informacionit rreth një gjyqtari që është kandidat për ngritje në detyrë, siç praktikohet në Mbretërinë e Bashkuar nga Komisioni i Emërimeve në Gjyqësor (JAC / KEGJ), mund të konsiderohet vlerësim informal.

3. Praktika në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës

4. Siç shpjegohet në këtë raport, praktika e vlerësimit të gjyqtarëve mbështetet tek raporti përmbledhës për pyetësorët e dorëzuar nga 33 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës për përgatitjen e Opinionit nr. 17 (2014) të CCJE-së. Siç theksoi CCJE, vendimi nëse dhe se si do të vlerësohen gjyqtarët është në mënyrë të pazgjithshme i lidhur me historinë dhe kulturën e një vendi dhe me atë të sistemit të tij ligjor⁵. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës përdorin një sistem formal për vlerësimin individual të gjyqtarëve. Këto shtete janë: Shqipëria, Austria, Belgjika,

² Raporti i periudhës 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësore (ENCJ) për standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mos-heqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit, më poshtë raporti i ENCJ-së, Kreu 2, faqe 10.

³ Raporti i periudhës 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësore (ENCJ) për standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mos-heqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit, më poshtë raporti i ENCJ-së, Kreu 2, f. 10.

⁴ Opinioni i CCJE-së 17 (2014) paragrafi 9, 10.

⁵ Opinioni i CCJE-së 17 (2014) paragrafi 22.

Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Moldavia, Monako, Polonia, Rumania, Sllovenia, Spanja, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqia. Veçanërisht në shtetet e Evropës Lindore, vlerësimi i gjyqtarëve është çështje e rëndësishme. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë shpjegon se vlerësimi i gjyqtarëve mund të promovojë pavarësinë e gjyqësorit. Rumania është e mendimit se vlerësimi është një mjet për të rritur besimin e publikut tek sistemi gjyqësor. Sllovenia deklaron se vlerësimi siguron llogaridhënien e gjyqësorit dhe, bashkë me të, dhe cilësinë e shërbimit gjyqësor.

5. Republika Çeke, Qiproja, Finlanda, Islanda, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Suedia, Zvicra, Ukraina, Mbretëria e Madhe nuk përdorin sisteme formale të vlerësimit. Këto shtete e konsiderojnë shpesh vlerësimin e gjyqtarëve si kërcënim të mundshëm për pavarësinë e gjyqësorit. Megjithatë, këto vende shpesh përdorin mjete jo-formale për vlerësimin, të cilat mund të ofrojnë një shtysë të vlefshme për zhvillimin e mjeteve që do të ndihmojnë në përmirësimin e sistemit gjyqësor. Për shembull Suedia, Zvicra, Finlanda, dhe Vendet e Ulëta, përdorin instrumente të caktuara vlerësimi për të siguruar që pagat e marra nga gjyqtarët janë në përpjesëtim me performancën e tyre (Suedia), për të dhënë komente për gjyqtarët për të përmirësuar punën dhe efikasitetin e tyre (Vendet e Ulëta, Zvicra), ose për t'u përgatitur për diskutime për zhvillimin e karrierës (Finlanda). Në Mbretërinë e Bashkuar, vlerësimi formal bëhet nga Komiteti i Emërimeve në Gjyqësor (JAC/KEGJ) kur është në diskutim ngritja e gjyqtarit në detyrë. Estonia, Luksemburgu dhe Ukraina i vlerësojnë formalisht gjyqtarët e emëruar rishtazi vetëm përpara se të bëjnë emërimin e tyre të përhershëm.

4. Modele të ndryshme vlerësimi lidhur posaçërisht me demokracitë e reja.

6. Qasja në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ndryshon si lidhur me mënyrën sesi ndërmerret vlerësimi (a) si dhe lidhur me personin ose organin përgjegjës për procesin e vlerësimit (b).

a. Procesi i vlerësimit

aa. Modeli i diskutimit

7. Në disa shtete procesi i vlerësimit kryhet në formën e një diskutimi, ku gjyqtari i vlerësuar prezanton punën e tij/saj dhe vlerësuesi/komisioni vlerësues bie dakord së bashku me gjyqtarin lidhur me karrierën dhe objektivat e tij për zhvillim (Belgjikë, Finlandë, Francë, Monako, Rumania). Gjatë diskutimit, gjyqtari i vlerësuar mund t'i bëhen po ashtu komente të cilat mund të ndihmojnë për përmirësimin e punës dhe performancës së tij (Zvicër). Këto diskutime mund të jenë informale (Finlandë, Zvicër), ose mund të realizohen në mënyrë zyrtare dhe të përfundojnë me një klasifikim/renditje të gjyqtarëve sipas performancës (Belgjikë, Francë, Monako, Rumania). Në rastin e fundit, procesi i vlerësimit fillon shpesh me vetëvlerësimin (Francë, Rumania).

bb. Modeli i raportit

8. Në shumë shtete anëtare, veçanërisht në demokracitë e reja, një grup vlerësuesish ose një vlerësues i vetëm mbledh informacionin e nevojshëm rreth gjyqtarit objekt vlerësimi dhe përgatit një draft-vlerësim (Austria, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Moldavia, Polonia, Sllovenia, Spanja, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqia). Vetëm kur është gati draft-raporti, gjyqtari objekt vlerësimi mund të komentojë mbi të. Vetëm në Qipro dhe në Gjeorgji gjyqtari objekt vlerësimi nuk merr pjesë në procesin e vlerësimit.

b. Organi përgjegjës për vlerësimin

aa. Modeli i kryetarit të gjykatës

9. Në disa shtete anëtare, për vlerësimin e gjyqtarit është përgjegjës vetëm një vlerësues. Zakonisht ky vlerësues është kryetari i gjykatës, ku gjyqtari objekt vlerësimi kryen detyrat e tij/saj (Gjermani, Hungari, Vendet e Ulëta). Vlerësuesi mbledh informacionin e nevojshëm për punën e gjyqtarit, punë e cila përfshin shpesh leximin e vendimeve të gjyqtarit, vizitat në seancat gjyqësore të drejtuara nga gjyqtari dhe marrjen në intervistë të gjyqtarit objekt vlerësimi dhe të kolegëve të tij. Vlerësuesi merr vendimin përfundimtar pasi i ka dhënë mundësinë gjyqtarit të japë komente për draft-vlerësimin paraprak (Gjermani, Hungari, Holandë).

bb. Modeli i këshillit

10. Në shtetet e tjera, veçanërisht në demokracitë e reja, Këshilli Gjyqësor, ose një vlerësues i vetëm, mbledh informacion për punën e gjyqtarit objekt vlerësimi dhe vendos për vlerësimin (Shqipëria, Austria, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Italia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Moldavia, Spanja, Turqia). Në disa shtete, në proces marrin pjesë nivele të ndryshme të këshillit dhe/ose kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari. Në Mbretërinë e Bashkuar në vlerësim marrin pjesë në procesin e vlerësimit si njerëz që nuk janë gjyqtarë ashtu edhe anëtarë të profesioneve ligjore dhe të gjyqësorit.

cc. Modeli i inspektimit

11. Në Poloni, vlerësimi individual i gjyqtarëve bëhet gjatë inspektimeve të rregullta të gjykatës, të kryera nga gjyqtarët inspektorë nga gjykata të tjera.

5. Kriteret

12. Në shumë shtete anëtare ka disa kriteret sasiore të cilat luajnë rol të rëndësishëm për vlerësimin e gjyqtarëve. Merret veçanërisht parasysh numri i çështjeve për të cilat është shprehur me vendim gjyqtari, koha e shqyrtimit të një çështjeje dhe koha mesatare për marrjen e vendimit (Austria, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Polonia, Rumania, Sllovenia, Turqia). Në shtete të tjera anëtare merret parasysh vetëm një tregues sasiore, numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim (Bosnje dhe Hercegovinë, Estoni, Hungari, për qëllimet e justifikimit të pagës së mbështetur në performancën e një gjyqtari: Spanjë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Ukraina). Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë një gjyqtar vlerësohet mbështetur në masën në të cilën ai ose ajo ka përmbushur një kuotë të caktuar (kuotën e orientimit të përcaktuar në Rregulloren për Kriteret e Orientimit për Performancën e Gjyqtarëve dhe të Oficerëve Gjyqësorë në Gjykatat në Bosnje dhe Hercegovinë, në Spanjë, kuota përcaktohet nga Këshilli për Gjyqësorin). Në procesin e vlerësimit, një gjyqtari i caktohet një numër pikësh në varësi të përqindjes së kuotës që ai/ajo ka realizuar. Kriteret e tjera janë nivelet e zgjidhjes së çështjeve (me marrëveshje) dhe respektimi i afateve kohore statutores për të marrë vendim për çështjet (Moldavi, Itali).

Mënyra sesi përdoren këto kriteret në vlerësim ndryshon shumë. Në disa shtete anëtare, të dhënat për kriteret të tilla sasiore, si, për shembull, numrin e çështjeve për të cilat është marrë një vendim, përkthehen në përqindje ose pikë që reflektojnë performancën e secilit gjyqtar individual krahasuar me gjyqtarë të tjerë (Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Estoni, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Italia, Turqia). Në shtete të tjera, faktorë të tillë sasiore ofrojnë vetëm pikën e nisjes për një vlerësim individual (Austri, Francë, Gjermani, Slloveni). Shtete të tjera anëtare nuk përdorin një grup fiks kriteresh për vlerësimin e gjyqtarëve (Belgjika, Monako).

13. Shumica e vendeve gjithashtu përdorin kriteret cilësore (kualitative) në procesin e vlerësimit, të tilla si sjellja e gjyqtarëve në seancat gjyqësore verbale; aftësitë e tyre të komunikimit kur flasin me avokatët, qytetarët dhe kolegët, (Gjermani, Moldova, Poloni, Slloveni). Nivelet e rasteve të kthimit për rigjykim, pra përqindjet e rasteve kur vendimi i një gjyqtari hidhet poshtë nga një gjykatë apeli, merren gjithashtu në konsideratë, (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjergjia, Greqia, Hungaria, Republika e mëparshme Jugosllave e Maqedonisë, Moldova, Polonia, Rumania, Turqia, Ukraina). Në shumë vende anëtare, cilësia e analizës së gjyqtarëve dhe kompleksiteti i çështjeve mbi të cilat ai ose ajo ka punuar konsiderohen si shumë të rëndësishme në procesin e vlerësimit, (Shqipëria, Belgjika, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Italia, Polonia, Rumania, Sllovenia). Në Gjermani, aftësia e gjyqtarit për të identifikuar pikat kritike në zhvillimin e një çështjeje, konsiderohet vendimtare për aftësitë e gjyqtarit. Shumë vende theksojnë se testohet cilësia e vendimit, dhe jo merita e një vendimi individual, me qëllim respektimin e pavarësisë së gjyqtarit. Faktorë të tjerë që merren parasysh në disa nga shtetet anëtare, janë aftësitë organizative të gjyqtarit dhe etika e punës, (Gjermania, Moldova, Polonia, Sllovenia, Suedia); aftësitë drejtuese (lidhshipi) (Gjermania, Hungaria); aftësia për ndërmjësime, për të hartuar vendime të qarta e të

kuptueshme, (Gjermani); dhe përdorimi i teknologjive të informacionit, (Kroacia, Moldova). Aktivitetet skolasike të gjyqtarit si mësimdhënia, publikimet dhe dhënia e leksioneve mund të merren gjithashtu parasysh, (Shqipëria, Kroacia, Gjermania, Sllovenia).

Komiteti i Emërimeve në Gjyqësor (JAC-KEGJ) në Mbretërinë e Bashkuar vlerëson një kandidat bazuar në kriteret e mëposhtëme: aftësia intelektuale, cilësitë personale, dhe aftësia për të kuptuar dhe për të trajtuar me ndershmëri/paanashmëri, autoriteti dhe aftësitë e komunikimit, dhe efikasiteti. Për pozicionet që kërkojnë aftësi menaxhuese, mund të vlerësohen aftësitë drejtuese dhe menaxhuese të kandidatit, në vend të efikasitetit të tij/saj.

6. Pasojat

14. Në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, rezultatet e vlerësimit kanë rëndësi të madhe në momentin kur merren vendimet për ngritjen në detyrë të një gjyqtari (Shqipëri, Austri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Francë, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Monako, Poloni, Rumani, Slloveni, Turqi, Mbretëria e Bashkuar). Në Rumani dhe Itali vetëm gjyqtarët që kanë marrë vlerësimin më të lartë (Rumani), ose të paktën kanë marrë një vlerësim pozitiv (Itali) mund të aplikojnë për ngritje në detyrë.

15. Në disa shtete, një gjyqtar i emëruar rishtazi mund të shkarkohet përpara marrjes së emërimit definitiv për shkak të rezultateve të këqija të vlerësimit (Bullgari, Estoni, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Ukrainë). Megjithatë, kjo çështje, e cila lidhet më shumë me emërimin e gjyqtarëve sesa me vlerësimin e gjyqtarëve në detyrë nuk do të shtjellohet në këtë raport.

16. Sisteme të tjera gjyqësore lejojnë shkarkimin e gjyqtarëve në detyrë pas një vlerësimi të dobët (Austria, Estonia, vetëm në raste të rralla: Greqia, Hungaria, Italia, Moldavia, Polonia, Rumania, Sllovenia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Për shembull, në Austri, Itali, Moldavi dhe Rumani një gjyqtar mund të shkarkohet nga detyra vetëm kur është vlerësuar me “pamjaftueshëm” dy herë. Nisja e proceseve disiplinore mund të jetë po ashtu pasojë e një vlerësimi të dobët (Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Greqi, Hungari, Poloni, Slloveni). Në disa shtete, një gjyqtari që është vlerësuar me “dobët” mund t’i kërkojë të marrë pjesë në kurse të posaçme trajnimi (Itali, Rumani).

17. Rezultatet e vlerësimit mund të kenë ndikim mbi pagën e gjyqtarit, si, për shembull, në Belgjikë, Bullgari, Spanjë, Suedi dhe Turqi. Në Suedi, vetëm një përqindje e vogël e pagës së gjyqtarit përcaktohet në mënyrë individuale, ndërsa ka garanci/masa mbrojtëse të forta për të ruajtur pavarësinë e gjyqtarëve në proces. Në Finlandë dhe Zvicër vlerësimet nuk bëhet me një qëllim të përcaktuar dhe nuk kanë pasoja, por kanë për qëllim të japin komente për çdo gjyqtar.

7. Mbrojtja e gjyqtarit objekt vlerësimi

18. Në pjesën më të madhe të sistemeve gjyqësore, gjyqtari merr pjesë në një lloj procesi vlerësimi, për shembull, duke dhënë një vetëvlerësim si pikë nisje për diskutimin, ose duke u intervistuar. Në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, gjyqtari ka të drejtën e komentit mbi një draft paraprak vlerësimi (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovina, Gjermani, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Poloni). Për më tepër, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, gjyqtari objekt vlerësimi duhet të konfirmojë saktësinë e të dhënave përkatëse, që përbejnë bazën e vlerësimit, dhe që janë marrë për këtë qëllim nga baza e të dhënave të gjykatës.

19. Në disa vende, gjyqtari që është objekt vlerësimi mund të kërkojë shkarkimin ose heqjen e një anëtari të organit vlerësues, nëse ka një arsye të shëndoshë, për shembull nëse anëtari perceptohet në mënyrë objektive që është i njëanshëm (Austri, Bullgari, Greqi, Moldavi, Romani, Turqi). Në Gjermani dhe Kroaci, mund të kërkojë heqja mbështetur në të njëjtat rregulla procedurale që rregullojnë heqjen të një gjyqtari (mundësisht) të paragjykuar në lidhje me një proces gjyqësor. Megjithatë, në shtete të tjera anëtare, gjyqtari nuk mund të kërkojë pushimin apo heqjen e një anëtari (që ka mundësi të jetë) të paragjykuar të organit vlerësues, (Austri, Belgjikë, Bosnje dhe Hercegovinë, Qipro, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Hungari, ish-Republika e Jugosllavisë, Monako,

Polonia, Suedia). Në disa nga këto vende, megjithatë, gjyqtari mund të kundërshtojë raportin e vlerësimit duke u bazuar në faktin që një gjyqtar i paragykuar ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit (Austri, Estoni, Francë, Poloni).

20. Në pjesën më të madhe të shteteve (në përjashtim të Belgjikës, Finlandës dhe Moldavisë) ekzistojnë mundësi për gjyqtarin objekt vlerësimi që të kërkojë një lloj rishikimi të vlerësimit. Zakonisht gjyqtari objekt vlerësimi mund t'i bëjë kërkesë një organi të posaçëm (Austri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Estoni, Francë, Greqi, Hungari) për të kërkuar rishikimin e vlerësimit, si, për shembull, plenumit të Këshillit për Gjyqësorin, kur raporti përgatitet nga një komitetet i këtij Këshilli (Bosnje dhe Hercegovinë, Estoni, Moldavi), ose disa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (Kroaci). Në Poloni, gjyqtari objekt vlerësimi duhet ta paraqesë opinionin e tij/saj me shkrim. Në Shqipëri, Gjeorgji, dhe Itali rezultatet e vlerësimit mund të kundërshtohen në gjykatë.

III. Standardet e CCJE-së

1. Pavarësia gjyqësore

21. CCJE-ja e thekson rëndësinë e pavarësisë së gjyqësorit si parakusht për ruajtjen e shtetit të së drejtës dhe si garanci themelore për procesin e rregullt gjyqësor.⁶ Pavarësia e gjyqësorit nuk duhet të mbrohet vetëm nga ndikimi i jashtëm, p.sh. nga ekzekutivi, por gjithashtu edhe nga ndikimet brenda gjyqësorit. Për pasojë, CCJE-ja e identifikon pajtimin e pavarësisë së gjyqësorit me vlerësimin individual të gjyqtarëve si çështje vendimtare. Në fund, duhet të mbizotërojë pavarësia e gjyqësorit.⁷ CCJE-ja deklaron po ashtu nevojën që çdo shtet anëtar i Këshillit të Evropës të ofrojë një sistem drejtësie të cilësisë më të lartë të mundshme dhe të sigurojë llogaridhënien e gjyqësorit në një sistem demokratik. CCJE-ja thekson se, një lloj vlerësimi është i nevojshëm për t'i arritur këto objektiva.⁸

2. Informal po, formal nëse nevojitet.

22. Në Opinionin 17 (2014), CCJE-ja mbështet pikëpamjen se prania e një lloj vlerësimi është e nevojshme⁹. Megjithatë, CCJE-ja nuk kërkon që shtetet anëtare të fusin në përdorim një sistem formal vlerësimi, përveçse kur arrihet në përfundimin se sistemi gjyqësor i një cilësie të lartë nuk mund të arrihet me mënyra të tjera. Megjithatë, CCJE-ja rekomandon që të gjitha shtetet anëtare të mendojnë me kujdes nëse duan të përdorin një sistem formal vlerësimi apo jo.¹⁰

23. CCJE-ja rekomandon që shtetet anëtare të përdorin vlerësime informale që ndihmojnë për përmirësimin e aftësive të gjyqtarëve dhe, në këtë mënyrë, për cilësinë e përgjithshme të gjyqësorit, si për shembull, vetëvlerësimin, komentet mbi punën e bërë dhe rishikimin informal nga kolegët.¹¹

3. Qëllimi: sistem gjyqësor i cilësisë më të lartë të mundshme

24. CCJE-ja deklaron që i gjithë vlerësimi duhet të synojë të përmirësojë gjyqësorin në tërësi.¹² Nëse ngritjet në detyrë mbështeten tek meritat (në veçanti aftësia, integriteti dhe eksperiencia) më shumë sesa tek vjetërsia në moshë ose hierarkia në detyrë, siç rekomandohet nga CCJE-ja dhe Kombet e Bashkuara¹³, prania e një lloj vlerësimi është e nevojshme. Për pasojë, CCJE-ja shpreh pikëpamjen se mbledhja e informacionit për përshtatshmërinë e ngritjes në detyrë mund të jetë qëllim i rëndësishëm i vlerësimit.¹⁴

⁶ Opinioni Nr. 1(2001) para 10; Rekomandimi CM/Rec(2010)12 para 3,11; CCJE *Magna Charta* e Gjyqatrëve (2010) para 2.

⁷ Opinioni 17 (2014), para. 46 i CCJE-së.

⁸ Opinioni 17 (2014), para. 23, rekomandimi 1 i CCJE-së.

⁹ Opinioni 17 (2014), para. 23, rekomandimi 1 i CCJE-së.

¹⁰ Opinioni 17 (2014), para. 23, rekomandimi 1, 2, i CCJE-së.

¹¹ Opinioni 17 (2014), para. 25, rekomandimi 4 i CCJE-së.

¹² Opinioni 17 (2014), para. 24, rekomandimi 3 i CCJE-së.

¹³ Shih Opinioni Nr. 1(2001), para. 17 dhe 29 të CCJE-së; Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), para. 13.

¹⁴ Opinioni 17 (2014), para. 27, i CCJE-së.

25. CCJE-ja i inkurajon shtetet anëtare të përdorin materialin e mbledhur gjatë procesit të vlerësimit individual të gjyqtarëve për të përmirësuar strukturën organizative të gjykatave dhe kushtet e punës së gjyqtarëve.¹⁵

4. Kuadri legjislativ dhe kriteret e vlerësimit

26. CCJE-ja është e mendimit se baza dhe elementët kryesorë të sistemit formal të vlerësimit duhet të përcaktohen qartë dhe në mënyrë shteruese në legjislacionin parësor. Këshilli për Gjyqësorin (në rastet kur ai ekziston) duhet të luajë rol të rëndësishëm për të ndihmuar për formulimin e këtyre çështjeve, veçanërisht për kriteret për vlerësim.¹⁶

27. CCJE-ja mbështet pikëpamjen se vlerësimi duhet të mbështetet në kriteret objektive, të cilat duhet të botohen.¹⁷ Standardet objektive nuk kërkohen vetëm për të përjashtuar ndikimin politik, por edhe për të shmangur rrezikun e përshtypjes së mundshme se ka favorizim, e cila është e pranishme nëse emërimet/vlerësimet bëhen në mënyrë të pastrukturuar, ose mbështetur në rekomandimet¹⁸ personale. Këto standarde objektive duhet të mbështeten në merita, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe eficientësinë¹⁹ dhe duke shqyrtuar të gjitha aspektet të përbëjnë performancë të mirë gjyqësore. Këto kriteret duhet të testohen duke përdorur tregues cilësorë. Përveç tyre, mund të përdoren dhe tregues sasiorë²⁰, të tilla si përqindjet dhe shifrat.

28. Duhet të shmanget shprehja e rezultateve të vlerësimit nëpërmjet shifrave, përqindjeve ose renditjes së gjyqtarëve pa shpjegime të mëtijshme, pasi kjo gjë mund të krijojë përshtypje të rreme për objektivitetin dhe siguri. CCJE-ja kundërshton shprehimisht çdo renditje të përhershme të gjyqtarëve siç bëhet në Shqipëri.²¹ Megjithatë, CCJE-ja e pranon që, në situata specifike, për shembull, në rastet kur më shumë se një gjyqtar aplikon për t'u ngritur në një pozicion të caktuar, një lloj forme renditjeje e këtyre kandidatëve është e paevitueshme.²²

29. CCJE-ja u bën thirrje shteteve anëtare që mos i vlerësojnë keq gjyqtarët për shkak të efekteve të kushteve të këqija të punës mbi të cilat gjyqtarët nuk mund të kenë ndikim. Si shembull, CCJE-ja i referohet vonesave që shkaktohen nga numri i madh i çështjeve të prapambetura të krijuara nga mungesa e personelit gjyqësor, ose nga përdorimi i një sistemi i papërshtatshëm administrativ.²³

5. Procedura dhe mbrojtja e gjyqtarit objekt vlerësimi

30. CCJE-ja deklaron se vlerësuesit duhet të jenë kryesisht gjyqtarë në mënyrë që të sigurohet pavarësia e gjyqësorit.²⁴ Për më tepër, vlerësuesit duhet të kenë kohë dhe burime të mjaftueshme. Gjyqtari objekt vlerësimi duhet të informohet se kush janë vlerësuesit dhe duhet të ketë të drejtën të kërkojë zëvendësimin e çdo vlerësuesi, i cili mund të perceptohet në mënyrë objektive si i njëanshëm.²⁵

31. Burimet e provave mbi të cilat bazohet vlerësimet duhet të jenë të mjaftueshme dhe të besueshme, veçanërisht nëse provat shërbejnë si bazë për një vlerësim të pafavorshëm.²⁶

¹⁵ Opinioni 17 (2014), para. 26, i CCJE-së.

¹⁶ Opinioni 17 (2014), para. 30, rekomandimi 5 i CCJE-së.

¹⁷ Shih Rekomandimin CM/Rec(2010)12, para. 58.

¹⁸ Opinioni 17 (2014), para. 31, i CCJE-së; Shih Opinion Nr. 1(2001), para. 24 të CCJE-së.

¹⁹ Shih Opininion Nr. 1(2001), para. 25 të CCJE-së.

²⁰ Opinioni 17 (2014), para. 31-35, rekomandimi 6 i CCJE-së.

²¹ Opinioni 17 (2014), para. 42 i CCJE-së.

²² Opinioni 17 (2014), para. 42-43, rekomandimi 7 i CCJE-së.

²³ Opinioni 17 (2014), para. 26 i CCJE-së.

²⁴ Opinioni 17 (2014), para. 37 i CCJE-së.

²⁵ Opinioni 17 (2014), para. 36 i CCJE-së.

²⁶ Opinioni 17 (2014), para. 39, 44, rekomandimi 9 i CCJE-së.

32. Në parim, vlerësimi individual i gjyqtarëve duhet të jetë i ndryshëm si nga inspektimet që vlerësojnë punën e përgjithshme të gjykatës, dhe nga procedurat disiplinore.²⁷

33. CCJE-ja thekson nevojën e drejtësisë/paanshmërisë procedurale në të gjithë elementët e vlerësimeve individuale. Gjyqtarët duhet të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre gjatë procesit të vlerësimit. Ata duhet të jenë po ashtu në gjendje të kundërshtojnë vlerësimet, veçanërisht kur vlerësimi cenon “të drejtat civile” të gjyqtarit objekt vlerësimi në kuptimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.²⁸

6. Pasojat

34. Rekomandimet e ministrave të Këshillit të Evropës²⁹ dhe të CCJE-së shprehin të dy pikëpamjen se përdorimi i vlerësimeve individuale për të përcaktuar pagën dhe pensionin e gjyqtarëve individualë duhet të shmanget, pasi ky proces mund të ketë ndikim mbi sjelljen e gjyqtarëve dhe, në këtë mënyrë, mund të rrezikojë pavarësinë e gjyqësorit.³⁰

35. Një vlerësim i vetëm i pafavorshëm nuk duhet të çojë në shkarkimin nga detyra të një gjyqtari (përveçse në raste përjashtimore). Çdo veprim për heqjen e një gjyqtari të paafte apo të korruptuar duhet të përmbushë standartet e larta të vendosura nga parimi i moslëvizjes së gjyqtarëve, pavarësia e të cilëve duhet të mbrohet³¹. Shkarkimi duhet të bëhet vetëm në rast të shkeljeve të rënda të rregullave disiplinore, ose të dispozitave penale të përcaktuara me ligj, ose kur përfundimi i pashmangshëm i procesit të vlerësimit është që gjyqtari nuk është i aftë, ose nuk është i gatshëm të përmbushë funksionet e tij juridike në nivelin e një standardi minimal të vlerësuar në mënyrë objektive.³²

36. Parimet dhe procedurat mbi të cilat mbështeten vlerësimet gjyqësore duhet t’i vihen në dispozicion publikut. Megjithatë, procesi dhe rezultatet e vlerësimeve individuale duhet, në parim, të mbeten konfidenciale, në mënyrë që të sigurohet pavarësia e gjyqësorit.³³

IV. Situata aktuale në Shqipëri

1. Materialet e përdorura

37. Përshkrimi dhe analiza e mëposhtme e situatës në Shqipëri mbështetet tek dokumentet e mëposhtme në versionin e tyre të përkthyer në anglisht:

38. Ligjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- Ligji Nr. 8236, datë 31. 08. 1996, ndryshuar me ligjin nr 9414, date 20.05.2005 “Për Shkollën e Magistraturës në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 8811, datë 17.05.2001, ndryshuar me ligjin nr 9448, datë 5.12.2005 “Ligji për Funkcionimin dhe Organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;
- Ligji Nr. 9877, datë 18.02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
- Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

²⁷ Opinioni 17 (2014), para. 29, 39, rekomandimi 10 i CCJE-së.

²⁸ Opinioni 17 (2014), para. 41, rekomandimi 11 i CCJE-së.

²⁹ Shih Rekomandimin CM/Rec(2010)12, para. 55; shih po ashtu Raportin e Përgjithshëm të IAJ-së (2006), Përfundime, para. 12.

³⁰ Opinioni 17 (2014) para 28, 45, rekomandimi 13 i CCJE-së

³¹ Raporti 2013-2014 i Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin mbi pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit, f. 59.

³² Opinioni 17 (2014), para. 29, 44, rekomandimi 12 i CCJE-së.

³³ Opinioni 17 (2014), para. 48, rekomandimi 14 i CCJE-së.

- Ligji nr. 97/2014, datë 24.7.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”;
- Ligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar më 31.07.2014.

39. Projektligjet

- Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë

40. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

- Vendimi nr. 137, datë 21.02.2003, në përputhje me nenin 33, paragrafi 3 i Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, “Rregullore për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”;
- Vendimi nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, në përputhje me nenin 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;
- Vendimi 238/1/b, datë 24.12.2008;
- Vendimi 261/2, datë 14/04/2010, në përputhje me nenin 1, 2 paragrafi dh i Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe nenet 13, 14 të Ligjit nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” dhe “Për kriteret e vlerësimit të aktivitetit gjyqësor, Shtojca 1”.
- Vendimi nr. 269/2, datë 27/09/2010 “Rregulla të detajuara për sistemin e vlerësimit, i cili është i detyrueshëm në rastin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve të lira në gjykatat e apelit dhe në gjykatat e krimeve të rënda”;
- Printim i listës së renditjes së disponueshme për publikun, marrë nga faqja e internetit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë më 1.3.2014;
- Shënim shpjegues i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për disa vendime të marra nga KLD-ja.

41. Dokumente të tjera zyrtare

- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë dhe Zëvendës Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 13.09.2012 “Për shmangien e mbivendosjes së kompetencave gjatë inspektimit gjyqësor”;
- Aleanca për Shqipërinë Evropiane, Programi i Qeverisë 2013-2017 – Gjenerata e Ardhshme, Shqipëri

42. Dokumente të tjera

- Rekomandimet e grupit të punës së Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i miratuar nga grupi i punës;
- “JuST – Projekti për forcimin e sektoritë gjyqësor” të USAID-it në Shqipëri, broshurë informative;
- Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë;
- Raport trajnimi i JuST-it “Sistemi i vlerësimit dhe inspektimit të gjyqtarëve në Shqipëri. Përafrimi me standardet ndërkombëtare”, përgatitur nga Albana Boksi dhe Valbona Vata;
- Drejt drejtësisë, analizë e çështjeve civile në gjykatat e rretheve gjyqësore, Prezenca e OSBE-së, 2012;
- Manual mbi procedurat e verifikimit të ankesave dhe inspektimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, EURALIUS III, tetor 2012.
- Komentet e OSBE-së, datë 15.07.2014 për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar më 31.07.2014.
- Fondacioni Slynn, Reforma e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, dokument për diskutim, 1 dhjetor 2014;

- Raundi i katërt i vlerësimit i GRECO-s, parandalimi i korrupsionit për sa i përket parlamentit, gjyqtarëve dhe prokurorëve, Raporti i Vlerësimit, Shqipëria, 2014.

43. Për më tepër, ekspertja pati privilegjin të takonte Z. Ildir Peçi (Zv/Ministër i Drejtësisë), Z. Sokol Berberi (gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese), Znj. Marsida Xhaferllari, (Kryeinspektore e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë), Z. Sokol Pasho, (Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë), dhe përfaqësues të tjerë nga Ministria e Drejtësisë, Znj. Rezarta Abdiu, Shefe e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Dhomën e Avokatisë, Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, si dhe me përfaqësues të OSBE-së, JuST-it, Euralius IV dhe Znj. Lora Ujkaj nga Delegacioni i Bashkimit Evropian gjatë qëndrimit të saj në Tiranë nga data 1 deri më 3 tetor 2014. Takimi me gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit në gjykata të ndryshme, dhe me këshilltarin ligjor të Gjykatës Kushtetuese më 3 tetor 2014 ishin me dobi të veçantë. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këto takime janë përfshirë në këtë analizë.

Më 30 janar 2015, ekspertja pati privilegjin të prezantonte një draft të këtij raporti në një tryezë të rrumbullakët: “Mbi sistemin aktual të vlerësimit individual të gjyqtarëve në Shqipëri, nën dritën e standarteve ndërkombëtare”, së bashku me Z. Marco Leidekker (Shef i zyrës së KiE në Tiranë), Z. Clive Rumbolt (Shef i Seksionit Politik, Ekonomik dhe të Informacionit të Delegacionit të BE në Tiranë), Z. Ildir Peçi (Zv/Ministër i Drejtësisë), Z. Ilir Mustafaj (Gjyqtar, Anëtar i KLD), Znj. Marsida Xhaferllari, (Kryeinspektore e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë) dhe Dr. Agnes Bernhard, Zv/Shefe e EURALIUS IV), dhe shumë gjyqtarë, inspektorë dhe përfaqësues të OJQ-ve, duke përfshirë Z. David Latham të Fondacionit Slynn. Raporti u përditësua si në bazë të komenteve të bëra gjatë eventit, ashtu edhe në bazë të komenteve të bëra me shkrim nga Z. Henry Brooke i Fondacionit Slynn.

Ekspertja është gjithashtu shumë mirënjohëse për kontributin e ofruar nga zyra e KiE në Shqipëri, veçanërisht ai i konsulentës kombëtare, Zj. Aida Bushati.

Raporti analizon situatën ligjore aktuale. Projekt-ligjet e hartuara në muajt e fundit nuk janë marrë në konsideratë.

2. Organizimi i gjykatave

44. Pushteti gjyqësor në Shqipëri ushtohet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë (neni 3 (1), i Ligjit Nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”). Gjykatat mund të krijohen me ligj për fusha të caktuara, si, për shembull, gjykatat administrative, në përputhje me nenin 7. Megjithatë, nuk mund të krijohen gjykata të jashtëzakonshme (neni 3 (2)). Në Shqipëri ka 38 gjykata: Gjykata e Lartë, 6 gjykata apeli dhe 22 gjykata të shkallës së parë (juridiksioni përgjithshëm); një gjykatë e shkallës së parë për krimet e rënda dhe një gjykatë apeli për krimet e rënda; gjashtë gjykata të shkallës së parë për mosmarrëveshjet administrative dhe një gjykatë apeli për mosmarrëveshjet administrative. Pra, gjykatat e shkallës së parë janë 22 gjykatat e rretheve gjyqësore; një gjykatë për krimet e rënda (neni 4) dhe gjashtë gjykata administrative të shkallës së parë. Gjykatat e shkallës së dytë janë 6 gjykatat e apelit (juridiksion i përgjithshëm), një gjykatë apeli për krimet e rënda dhe një gjykatë administrative apeli (neni 5).

Kompetencat territoriale të gjykatave përcaktohen në një dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Ministri e bën propozimin pas marrjes së opinionit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (më poshtë KLD-ja) (neni 6).

3. Emërimi i gjyqtarëve

a. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)

45. Sipas nenit 1 të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nr. 8811, datë 17.05.2001, ndryshuar nga Ligji nr. 9448, datë 05.12.2005, përcaktohet se KLD-ja është organi përgjegjës për emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, karrierën, vlerësimin dhe kontrollin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Presidenti i Republikës emëron

gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave mbështetur në propozimin e KLD-së. KLD emëron kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit (neni 2 a), e) Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nr. 8811, datë 17.05.2001, ndryshuar nga Ligji nr. 9448, datë 05.12.2005; neni 16 i Ligjit nr. 9877/2008 “Mbi organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”)

46. KLD-ja përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, tre anëtarë të përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (të cilët duhet të jenë juristë me jo më pak se 15 vite eksperiencë në profesion (neni 3, 4), dhe nëntë gjyqtarë nga të gjitha nivelet e gjykatave të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore (neni 3), të cilët duhet të kenë minimalisht dhjetë vjet eksperiencë (neni 4) si gjyqtarë. Anëtarët e zgjedhur shërbejnë për një mandat pesëvjeçar. Pozicioni në KLD është i papajtueshëm me postin e prokurorit publik, avokatit në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, dhe anëtarësimin dhe/ose pozicionet në parti politike (neni 5 i ndryshuar nga ligji i ri, datë 31.07.2014). Anëtarët e KLD-së të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare e Gjyqtarëve nuk mund të transferohen ose të ngrihen në detyrë edhe në rast se japin dorëheqjen përpara përfundimit të mandatit pesëvjeçar (neni 6 i ndryshuar nga ligji i ri, datë 31.07.2014).³⁴ Kryetari i KLD-së është Presidenti, ndërsa zëvendëskryetarët, të zgjedhurit e vetëm që punojnë me kohë të plotë në KLD, duhet të zgjidhen nga anëtarët e KLD-së, ndërmjet anëtarëve të përzgjedhur nga parlamenti (neni 12, i ndryshuar nga ligji i ri, datë 31.07.2014).

b. Emërimi dhe ngritja në detyrë

47. Është e rëndësishme të theksohet se jo vetëm emërimi i një gjyqtari të gjykatës së shkallës së parë në një gjykatë apeli konsiderohet si ngritje në detyrë, por edhe transferimi nga një gjykatë rrethi të vogël në një gjykatë të një qyteti më të madh, veçanërisht në Tiranë. Prandaj është e rëndësishme që këto transferime gjithashtu të bëhen sipas kriterëve objektive bazuar në meritë.

48. Sipas nenit 11 (1) Ligji nr. 9877, datë 18. 02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, një qytetar shqiptar mund të emërohet gjyqtar nëse ai, ose ajo ka përfunduar arsimin e lartë dhe shkollën e magistraturës, nuk është dënuar për kryerjen e një vepre penale, dhe ka cilësi dhe aftësi të larta morale dhe profesionale. Megjithatë, sipas pikës (2), deri në 10% e gjyqtarëve mund të përzgjidhen nga kandidatët që kanë punuar më parë si gjyqtarë dhe që i plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme, përveç përfundimit të shkollës së magistraturës.

49. Emërimi i gjyqtarëve trajtohet në nenin 11-12 të Ligjit Nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Gjyqtarët e shkallës së parë dhe gjyqtarët e gjykatave të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (neni 12 (1)). Gjyqtarët mund të emërohen në gjykatën e apelit, ose në gjykatën e krimeve të rënda pas konkursit me curriculum vitae. Kandidatët duhet të jenë dalluar për aftësi profesionale dhe për etikë të lartë morale, dhe nuk duhet të kenë një masë disiplinore në fuqi. Për më tepër, ata duhet të kenë marrë vlerësimin “shumë mirë” gjatë dy vlerësimeve të fundit (neni 12 (2) b-d, (3) b-d). Një gjyqtar duhet të ketë punuar për jo më pak se pesë vjet në një gjykatë të shkallës së parë përpara ngritjes në detyrë në gjykatën e krimeve të rënda (neni 12 (2)a), dhe shtatë vjet përpara ngritjes në detyrë në një gjykatë apeli (neni 12 (3) a). Ndërmjet kandidatëve që i plotësojnë kriteret e shpjeguara në nenin 12 (2) dhe (3), KLD-ja i përzgjedh kandidatët sipas një liste të përhershme të renditjes së gjyqtarëve (neni 12 (4)), të parashikuar në nenin 14. Gjyqtarët e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe të dytë caktohen bazuar në kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 49/2012 “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, (neni 5). Sipas nenit 5 të ligjit për gjykatën administrative, çdo qytetar shqiptar që ka punuar si gjyqtar për të paktën 5 vjet mund të emërohet si

³⁴ Prezenca e OSBE-së ka komentuar në favor të këtyre ndryshimeve, pasi ato do të ndihmojnë të shmangien e favorizimit: Komente për projektligjin „Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, „Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

gjyqtar i gjykatës administrative të shkallës së parë. Me nëntë vjet eksperiencë, një gjyqtar mund të caktohet si gjyqtar i gjykatës administrative të apelit. Gjyqtarët e gjykatës administrative emërohen nëpërmjet një procedure me dy faza: së pari, një test me shkrim dhe, më pas, përzgjedhje nga KLD. Ligji nuk ofron rregulla specifike mbi ngritjen në detyrë dhe procedurat disiplinore për gjyqtarët e gjykatave administrative. Megjithatë, rregullat e parashikuara në Ligjin nr. 9877/2008 “Mbi organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, zbatohet për këto çështje, për sa kohë ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 (1) të ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

50. Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit përzgjidhen dhe emërohen nga KLD-ja, sipas nenit 16. Ata nuk duhet të kenë punuar më pak se katër vjet si gjyqtar në gjykatat e të njëjtit nivel, ose të një niveli më të lartë, duhet të kenë marrë vlerësimin “shumë mirë” dy herët e fundit të vlerësimit, të mos kenë marrë masë disiplinore kundër tyre në fuqi, të kenë aftësi organizative dhe drejtuese dhe të mos jenë anëtarë të KLD-së. Sipas nenit 17, kryetarët kanë mandat katërvjeçar me të drejtë riemërimi. Kryetarët e gjykatave përmbushin shumë detyra administrative, ndërmjet të tjerash dhe përfaqësimin e gjykatave lidhur me palët e treta (neni 18 (3) a), ndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione (neni 18 (1), (3) b), kontrollin e disiplinës në punë dhe të etikës së gjyqtarëve (neni 18 (3) d,e), si dhe mbajnë kontakte me Shkollën e Magjistraturës, KLD-në dhe Ministrinë e Drejtësisë (më poshtë MD) për çështje të lidhura me përmirësimin profesional të gjyqtarëve (neni 18 (3) ë).

4. Statusi i gjyqtarit

51. Ligji nr. 9877, datë 18. 02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përmban po ashtu rregulla për statusin e gjyqtarit (Kreu IV). Sipas nenit 20, gjyqtari nuk mund të largohet nga detyra, në përjashtim të rasteve kur ai jep dorëheqjen, arrin moshën 65 vjeç, dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ose kur shkarkohet nga detyra. Një gjyqtar nuk mund të transferohet pa pëlqimin e tij/saj (neni 21 (1)). Megjithatë, neni 21 i ligjit nr. 9877 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neni 147 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë lejon transferimin e një gjyqtari kundër dëshirës së tij, nëse ri-organizimi i gjykatës e kërkon një gjë të tillë. Gjyqtarët ndalohen të jenë anëtarë të një partie politike, ose të marrin pjesë në aktivitete politike. Ata nuk lejohen as të marrin pjesë në administrimin ose drejtimin e kompanive tregtare, të jenë gjyqtarë arbitra, ose ekspertë në një proces arbitrazhi, të futen në grevë, të bëjnë deklarata publike lidhur me proceset gjyqësore, ose të kryejnë asnjë aktivitet tjetër që mund të cenojë paanshmërinë e tyre. Gjyqtarët duhet të respektojnë rregullat për veshjen dhe për solemnitetin e procesit gjyqësor (neni 25). Të drejtat, përfitimet dhe pagesa e gjyqtarëve rregullohen po ashtu në Ligjin nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 24, 26, 27. Përgjegjësitë penale dhe civile të gjyqtarëve mbulohen nga neni 29 dhe 30.

5. Vlerësimi i gjyqtarëve

a. Kuadri institucional

52. Inspektorati i KLD-së (rregulluar me nenet 14-17 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar me ligjin 9448 datë 05.12.2005 dhe me ligjin e datës 31.07.2014), është institucioni që kryen pjesën më të madhe të punës lidhur me vlerësimin e gjyqtarëve. Për më tepër, një degë e Inspektoriatit shqyrton ankesat e bëra nga publiku kundër disa gjyqtarëve. Kuadri ligjor për këtë institucion ka qenë në fuqi që prej vitit 2006, (Rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, e aprovuar nga KLD me vendimin nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, ndryshuar me vendimin nr. 207/1, datë 07.02.2007). Megjithatë struktura u implementua vetëm në 2013. Inspektorati i KLD-së përbëhet nga Kryetari i i Inspektoriatit ose nga Kryeinspektori, dhe nga inspektorët të cilët emërohen dhe shkarkohen nga KLD-ja me propozim të Zëvendës Kryetarit. Kryeinspektori organizon detyrat e inspektoratit, siç parashikohet në nenin 16, pra konkretisht vlerësimin e gjyqtarëve. Kandidatët për pozicionin e inspektorit përzgjidhen për një mandat pesëvjeçar, pas njoftimit publik dhe duhet të përmbushin

kriteret për t'u emëruar gjyqtar i gjykatës së apelit. Në rast se nuk ka kandidatë të tillë, inspektorët përzgjidhen ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë për jo më pak se pesë vjet (neni 14 dhe 15).

53. Një ndryshim i ri i datës 31.07.2014, i nenit 14 të Ligjit 8811 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", parashikon që puna e Kryeinspektorit dhe e inspektorëve vlerësohet një herë në dy vjet dhe se kryeinspektori paraqet një raport për punën e Inspektoratit të KLD-së çdo vit.

54. Çdo gjyqtar vlerësohet nga një inspektor i caktuar, i cili përgatit projektvlerësimin për Kryeinspektorin. Më pas Kryeinspektori kontrollon projektvlerësimin dhe cakton renditjen/klasifikimin e përgjithshëm, i cili më pas ri-konfirmohet ose ndryshohet nga KLD-ja. Puna e Inspektoriatit të KLD filloi praktikisht vetëm në 2013, me caktimin e Krye/Inspektoreve aktuale. Në 2014, të gjithë gjyqtarët janë vlerësuar pozitivisht për punën e tyre në periudhën 2005/2006. Aktualisht, Inspektorati i KLD-së po punon për periudhën 2007-2009³⁵.

b. Legjislacioni parësor

55. Neni 13 i ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" përcakton që çdo gjyqtar i gjykatave të shkallës së parë dhe i gjykatave të apelit duhet të vlerësohet në mënyrë profesionale të paktën një herë në tre vjet, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara nga KLD-ja (neni 13 (1)). Sipas nenit 13 (2), një gjyqtar mund të vlerësohet "shumë mirë", "mirë", "pranueshëm" dhe "i paaftë". Vlerësimi "i paaftë" përbën arsye për të filluar procedurën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit objekt i këtij vlerësimi. Një gjyqtar që vlerësohet me "pranueshëm" duhet të rivlerësohet brenda të njëjtit vit. (neni 13 (4)).

c. Vlerësimi siç rregullohet në vendimet e KLD-së

56. Detajet e procesit të vlerësimit dhe kriteret që duhet të përdoren gjatë procesit parashikohen në Vendimin 261/2, datë 14/04/2010 në përputhje me nenin 1, 2 germën dh të Ligjit nr. 8811, datë 17/05/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" (më poshtë: Vendimi 261/2) dhe nenit 13, 14 të Ligjit n. 9877, datë 18.02. 2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë Vendimi 261/2) "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve" dhe "Për kriteret e vlerësimit të aktivitetit gjyqësor Shtojca 1" (më poshtë Shtojca 1).

aa. Qëllimi

57. Sipas nenit 1 të Vendimit 261/2, qëllimi i sistemit të vlerësimit për gjyqtarët është nxjerrja në pah e cilësive profesionale në kuadrin e mundësive të tyre për zhvillim karriere, identifikimi i performancës gjyqësore me cilësi të ulët dhe të lartë, identifikimi i problemeve të gjykatave dhe i nevojave për trajnim për gjyqtarët. Sipas nenit 2 (1) të Vendimit 261/2, do të vlerësohen të gjithë elementët e punës së gjyqtarit. KLD-ja përcakton çdo vit në nëntor gjykatat ku do të vlerësohen gjyqtarët vitin që vjen (neni 2 (6) i Vendimit 261/2). Vlerësimet përgatiten nga Inspektorati i KLD-së si në formë përshkrimi dhe duke përdorur tabelat statistikore. Vendimi përfundimtar për vlerësimin e gjyqtarëve bëhet nga KLD-ja, neni 2 (2) i Vendimit 261/2.

bb. Procesi i vlerësimit

58. Sipas nenit 2 (3) të Vendimit 261/2, procesi i vlerësimit ka tri faza:

1. Vlerësimi nga kryetari i gjykatës ku kryen detyrat gjyqtari objekt vlerësimi (neni 19), pasuar nga një vetëvlerësim vullnetar i vetë gjyqtarit ose gjyqtarës (neni 20).

³⁵ Shiko: Fondacioni Slynn "Reforma e sistemit gjyqësor në Shqipëri – dokument për diskutim 2014, f.7; GRECO Raundi i katërt i vlerësimit – Shqipëria 2014, paragrafi 73.

2. Raporti konstatues dhe projekt-akti i vlerësimit nga Inspektorati i KLD-së, i përgatitur mbështetur në kriteret e përcaktuara në Kreun II dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 27, 28.
3. Vendimi përfundimtar i vlerësimit (akti i vlerësimit) nga KLD-ja (neni 32).

59. Sipas vendimit 261/2, vlerësimi mbështetet mbi të dhënat e mbledhura nga gjykata ku gjyqtari i ushtron detyrat e tij/saj (neni 2 (4, 5) i Vendimit 261/2). Për çdo gjyqtar, përpilohet një tabelë statistikore, e cila përfshin:

- numrin e çështjeve të shqyrtuara nga një gjyqtar brenda një viti;
- numrin e çështjeve të apeluara në gjykatat e larta dhe, ndërmjet tyre, numrin e çështjeve të kthyer dhe të konfirmuara. Tabela përfshin përqindjen e numrit të çështjeve të rrëzuara, të ndryshuara ose të lëna në fuqi nga gjykatat më të larta.
- Tabela duhet të përfshijë po ashtu numrin e çështjeve për të cilat gjyqtari i ka tejkaluar afatet kohore të përcaktuara nga KLD-ja. Ky numër duhet të krahasohet me numrin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari.

cc. Kriteret

60. Në Kreun II të Vendimit 261/2, trajtohen kriteret e vlerësimit. Sipas nenit 3, duhet të bëhet dallimi ndërmjet tri grupesh kriteresh vlerësimi:

- (a) grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese (siç parashikohet në Seksionin I, neni 4-8);
- (b) grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike (të parashikuara në Seksionin II, nenet 9-12)
- (c) grupi i kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional (siç parashikohet në Seksionin III, nenet 13-17).

Qasjet sasiore dhe cilësore përdoren për të vlerësuar kriteret në Seksionin I, ndërsa për Seksionin II dhe III përdoren kritere cilësore.

61. Në Seksionin I,

Duhet të vlerësohet:

- efektiviteti dhe produktiviteti i gjyqtarit, neni 4 a, neni 5 i Vendimit 261/2),
- metodologjia (neni 4 b, neni 6 i Vendimit 261/2),
- shpejtësia (neni 4 c, neni 7 i Vendimit 261/2) dhe
- planifikimi i seancave gjyqëore (neni 4 d, neni 8 i Vendimit 261/2).

62. Lidhur me vlerësimin e efektivitetit të gjyqtarit vlerësohen të dhënat statistikore. Efektiviteti i gjyqtarit kontrollohet sipas standardeve orientuese të performancës gjyqësore përsa i përket cilësisë, sasisë dhe përpikmërisë në kohë në Shtojcën 1. Në këtë kuadër përdoren kritere sasiore, të tilla si numri i çështjeve për të cilat gjyqtari objekt vlerësimi është shprehur me vendim, numri i vendimeve të kthyer nga apeli. Standardet e cilësisë kërkojnë që gjyqtari të menaxhojë një ngarkesë minimale pune përgjatë një viti kalendarik. Ngarkesa minimale e punës matet ndryshe, sipas gjykatës dhe seksionit ku bën pjesë gjyqtari i vlerësuar. Për shembull, gjyqtari në seksionin penal të gjykatës së shkallës së parë duhet të përmbushë ngarkesën e shqyrtimit të 100 çështjeve penale në vit si relator, ndërsa një gjyqtar në gjykatën e krimeve të rënda nuk duhet të shqyrtojë më pak se 10 çështje penale. Një gjyqtar i gjykatës së apelit, seksioni civil, duhet të shqyrtojë jo më pak se 200 çështje si relator (Shtojca 1, 3.).

63. Standardi i cilësisë i parashikuar në Shtojcën 1 kërkon që numri i vendimeve të kthyer të mos jetë më shumë se 30% e vendimeve të apeluara (Shtojca 1, 4). Standardi i shpejtësisë kërkon që gjyqtari objekt vlerësimi t'i realizojë proceset gjyqësore brenda afatit maksimal. Afatet kohore

ndryshojnë sipas fushës së çështjes. Një proces gjyqësor që ka të bëjë me një mosmarrëveshje tregtare në gjykatën e shkallës së parë nuk duhet ta tejkalojë periudhën prej 6 muajsh, ndërsa një mosmarrëveshje familjare duhet të zgjidhet brenda 4 muajsh. Një proces në gjykatën e krimeve të rënda nuk duhet ta tejkalojë afatin prej 12 muajsh.

64. Vizita në KLD dëshmoi se raportet e vlerësimit janë të gjata dhe të detajuara. Shifrat dhe statistikat lidhur me sasinë dhe cilësinë e vendimeve analizohen me kujdes dhe për to jepen arsye të detajuara. KLD ka zhvilluar praktika për interpretimin e kriterëve të vlerësimit abstrakt. Për shembull, përqindja e ndryshimit të vendimit të çështjeve nuk përdoret thjesht për vlerësim, por analizohet më tej çdo rast i tillë. Vetëm në rastet kur ndryshimi i vendimit shkaktohet nga gabime të qarta procedurale dhe ligjore të gjyqtarit objekt vlerësimi, ai llogaritet si negativ. Për më tepër, cilësia e vendimeve të gjyqtarit objekt vlerësimi analizohet me kujdes, duke i kushtuar rëndësi strukturës logjike të vendimit, aftësisë bindëse të tij, gabimeve në të shkruar, përdorimit të gramatikës dhe qartësisë së shprehjes. Inspektorati i KLD-së dhe Kryeinspektorja e tij na dhanë përshtypjen se përgjegjësitë e vlerësimit gjyqësor nuk merrreshin lehtë, por ndiqeshin rregullat e legjislacionit me kujdes.

65. Neni 6, kriteri për metodologjinë e gjyqtarit, shërben për vlerësimin e aftësisë të gjyqtarit për të planifikuar dhe për të marrë masat e nevojshme procedurale dhe administrative brenda ose jashtë gjykatës pjesë e së cilës ajo/ai është. Neni 7, kriteri i „shpejtësisë“ shërben për të vlerësuar aftësinë e gjyqtarit për t'i gjykuar çështjet brenda afateve kohore të arsyeshme, ose për t'i përfunduar këto çështje. Duket se ka një mbivendosje midis standartit “të përpikmërisë në kohë, të përshkruar në shtojcën 1 dhe kriterit “të shpejtësisë” të parashikuar në nenin 4 c, nenin 7 të Vendimit 261/2. Neni 8 i kërkon një vlerësuesi të vlerësojë aftësinë e gjyqtarit për të planifikuar seancat gjyqësore në mënyrë të drejtë dhe në kohën e duhur, në mënyrë që të përmbyllë me efektivitet çështjet në kohë.

66. Në Seksionin II, i cili është seksioni më i rëndësishëm po të marrim parasysh vlerësimin e përgjithshëm të një gjyqtari (shih nenin 29 të Vendimit 261/2), duhet të vlerësohen aftësitë profesionale gjyqësore dhe teknike të gjyqtarit. Në këtë seksion duhet të vlerësohet nëse gjyqtari është në gjendje të:

- hartojë vendime të qarta (neni 9 a, neni 10 i Vendimit 261/2). Kriteri i “hartimit të vendimeve të qarta” teston aftësitë e një gjyqtari për përgatitjen e vendimeve gjyqësore në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, në mënyrë që vendimi të jetë i thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë (neni 10).
- neni 9 b, 11 shërben për të vlerësuar aftësinë e gjyqtarit për të menaxhuar një proces të rregullt gjyqësor, për të orientuar dhe drejtuar drejt debatin ligjor, dhe për t'u shprehur qartë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të etikës ligjore.
- Neni 9 c, 12 i Vendimit 261/2 i kërkon që vlerësuesi të vlerësojë kompetencën e gjyqtarit për të krijuar dhe për të organizuar një dosje gjyqësore në një mënyrë që e bën atë gati për përdorim.

67. Në përputhje me Seksionin III, vlerësohet kapaciteti njerëzor i gjyqtarit objekt vlerësimi dhe angazhimi i tij ose i saj profesional. Këtu vlerësuesit duhet të rishikojnë:

- sensin e etikës së gjyqtarit gjatë dhe jashtë proceseve gjyqësore (neni 13 a, 14 i Vendimit 261/2). Ky kriter, siç parashikohet në nenin 14, synon të vlerësojë aftësitë komunikuese të gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore dhe mënyrën sesi sillet ai.
- solemnitetin dhe disiplinën e gjyqtarit në punë (neni 13 b), 15 i Vendimit 261/2); ky kriter sheh aftësinë e gjyqtarit për realizimin e një procesi ligjor solemn, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tij dhe për respektimin e disiplinës në punë.

- së fundmi, merret parasysh pjesëmarrja dhe përfshirja e gjyqtarit në aktivitete profesionale dhe trajnuese (neni 13 c, 16 i Vendimit 261/2).

- puna e gjyqtarit si studiues ligjor merret parasysh në përputhje me nenin 13 d, 17 të Vendimit 261/2.

ee. Informacioni i përdorur në procesin e vlerësimit

68. Neni 23 i Vendimit 261/2 përfshin rregulla të detajuara për mënyrën e mbledhjes së të dhënave mbi performancën e gjyqtarit objekt vlerësimi:

- shtatë dosje mbi të cilat ka punuar gjyqtari përzgjidhen nga Inspektorati duke përdorur sistemin e shortit (i parashikuar në detaje në nenin 24).
- Pesë vendime përzgjidhen nga vetë gjyqtari.
- Mblidhen vendimet e gjyqtarit që janë kthyer ose ndryshuar nga gjykata më të larta. Inspektori në fjalë inspekton të gjithë dosjen gjyqësore të secilës çështje për të identifikuar arsyet e rrëzimit.
- Të dhënat nga 20% e çështjeve për të cilat është marrë një vendim nga të gjyqtari objekt vlerësimi përzgjidhen me short.
- Mblidhen të dhënat nga ankesat e bëra kundër gjyqtarit (ankesat duhet të jenë të verifikuara).
- Merren parasysh të dhënat nga inspektimi i gjykatës.
- Merret parasysh po ashtu dhe vlerësimi i bërë nga kryetari i gjykatës.
- Në procesin e vlerësimit duhet të përdoret dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit në rast se ai ose ajo e ka plotësuar formularin përkatës.

Në praktikë, inspektorët shpjeguan se ata vlerësojnë gjer 100 vendime për gjyqtar.

69. Në mënyrë që të vlerësohet pjesëmarrja e gjyqtarit objekt vlerësimi në aktivitetet e trajnimit, inspektori i ngarkuar me vlerësimin i kërkon informacion Shkollës së Magjistraturës (neni 25). Shkolla e Magjistraturës jo vetëm organizon dhe realizon edukimin e juristëve të rinj të cilët duan të bëhen gjyqtarë, por ofron dhe kurse për arsimin vazhdues të gjyqtarëve (shih nenin 2 të Ligjit për “Shkollën e Magjistraturës”, nr. 8136, datë 31.07.1996, i ndryshuar me Ligjin nr. 9414, datë 20.05.2005 dhe ligjin 97/2014, datë 31.07.2014). Për qëllim të vlerësimit gjyqësor, Shkolla ofron një listë që tregon ftesat që ka marrë gjyqtari objekt vlerësimi për të marrë pjesë në kurset e Shkollës së Magjistraturës dhe numrin e herëve kur ai/ajo ka marrë pjesë faktikisht në këto kurse në Shkollën e Magjistraturës. Siç shpjegoi dhe Kryeinspektorja e Inspektoratit të KLD-së pjesëmarrja ose mungesa e një gjyqtari merret shumë parasysh në rast të kurseve të organizuara që kanë rëndësi të posaçme për fushën e së drejtës ku e kryen aktivitetin gjyqtari/gjyqtarja objekt vlerësimi.

70. Gjyqtari objekt vlerësimi mund të kërkojë po ashtu organizimin e një interviste personale në Inspektoratin e KLD-së, e cila kryhet ose nga inspektori përgjegjës për vlerësimin, ose nga Kryeinspektori (neni 26 i Vendimit 261/2).

ff. Vlerësimi

71. Kryeinspektori i Inspektoratit të KLD-së harton projekt/raportin e vlerësimit dhe e vlerëson gjyqtarin me vlerësimin “shumë mirë”, “mirë”, “pranueshëm” ose “i paaftë” (Neni 28 i Vendimit 261/2). Vlerësimet bëhen sipas vlerësimeve të bëra në tre seksionet e përmendura më sipër. Një gjyqtar merr vlerësimin e përgjithshëm “shumë mirë” në rast se ai ose ajo ka marrë vlerësimin “shumë mirë” në të tria seksionet, ose vlerësimin “shumë mirë” në seksionin II dhe një tjetër “shumë mirë” dhe një tjetër vlerësim “mirë” në dy seksionet e tjera. Një gjyqtar duhet të marrë vlerësimin e

përgjithshëm “i paaftë” në rast se ai/ajo është vlerësuar me “i paftë” në të paktën dy ose tre seksione. Vlerësimi i përgjithshëm si “i paaftë” mund të mbështetet dhe tek vlerësimi “i paaftë” në pjesën II dhe vlerësimi jo më shumë sesa “pranueshëm” në të dy pjesët e tjera. Në rast se një gjyqtar vlerësohet si “i paaftë” në një seksion, ai/ajo nuk mund të marrë një vlerësim të përgjithshëm më të lartë se “pranueshëm” (neni 29).

72. Vlerësimi “pranueshëm” çon në ri-vlerësim brenda vitit³⁶. Vlerësimi si “i paaftë” sipas nenit 13 (2) të Ligjit Nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas nenit 13(3), përbën “arsye për fillimin e procedurës për shkarkimin e gjyqtarit nga detyra”. Megjithatë neni 13 nuk përmendet në nenet 32, 33, kështu që nuk është tërësisht e qartë nëse “procedura e shkarkimit” e përmendur më sipër nënkupton procedurën disiplinore sipas Kreut V të ligjit. Sipas informacionit të dhënë nga Inspektorati i KLD-së, deri tani asnjë gjyqtar nuk është vlerësuar si “i paaftë”. Megjithatë, do të ishte e preferueshme që rregullat procedurale mbështetur në të cilat mund të shkarkohet një gjyqtar të parashikohen qartë në legjislacionin parësor.

gg. Rishikimi dhe vendimi përfundimtar

73. Sipas nenit 30 të Vendimit 261/2, gjyqtari objekt vlerësimi mund të depozitojë një ankesë në KLD kundër vlerësimit të kryeinspektorit. Në këtë rast, KLD-ja e dëgjon gjyqtarin objekt vlerësimi dhe Kryeinspektorin (Neni 31 i Vendimit 261/2).

74. Pavarësisht nga ankesa, KLD-ja merr një vendim përfundimtar për vlerësimin e gjyqtarit. Në rast se KLD-ja e konsideron vlerësimin shumë pozitiv, një anëtar i KLD-së, i cili është gjyqtar, përgatit një raport të ri vlerësimi brenda dhjetë ditësh. Gjyqtari objekt vlerësimi dëgjohej përpara se të merret vendimi për vlerësimin në seancë plenare.

75. Më pas vendimi i arsyetuar i KLD-së bëhet pjesë e dosjes personale të gjyqtarit objekt vlerësimi (neni 32 i Vendimit 261/2). Në Shqipëri, është pranuar mundësia për të kërkuar rishikim gjyqësor të vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si akt administrativ. Aktualisht një numër çështjesh në lidhje me këto raste janë duke u gjykuar në nivel gjykate apeli. Megjithatë mungojnë rregullat procedurale që rregullojnë rishikimin gjyqësor të vendimeve të KLD-së.

është konfirmuar nga një vendim i Gjykatës së Lartë në vitin 2013.

hh. Vlerësimi i kryetarëve të gjykatave

76. Si gjyqtarë, kryetarët e gjykatave të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit vlerësohen mbështetur në të njëjtat kritere ashtu si edhe gjyqtarët e zakonshëm (neni 18 i Vendimit 261/2). Kryetarët e gjykatave vlerësohen gjithashtu për aftësinë e tyre si administratorë të gjykatave. Kryetarët e gjykatave zgjidhen për katër vjet, me të drejtë ri-zgjedhjeje. Bazuar në vendimin e KLD nr. 227/2 datë 28/03/2008 “Mbi funksionin e kryesimit të gjykatës”, Krye/Inspektori i KLD, çdo dy vjet (or kurdo që të kërkohet nga KLD), përgatit dhe dorëzon një raport në mbledhjen plenare të KLD, mbi punën e kryetarit të gjykatës. Raporti përgatitet nga Krye/Inspektori i KLD dhe merr në konsideratë një sërë burimesh, si p.sh. analiza vjetore e gjykatës, treguesit e performancës së gjykatës bazuar në statistikat gjyqësore, vizitat nga anëtarë të ndryshëm të KLD, informacione mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, informacione nga Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor, Prokuroria dhe Dhoma e Avokatisë. Raporti diskutohet më pas me kryetarin e gjykatës dhe ai ose ajo ka të drejtë të bëjë vërejtje. Raporti diskutohet në mbledhjen plenare të KLD dhe mund të shërbejë si nxitje për shkarkimin e tij/të saj nga detyra e kryetarit të gjykatës. Çdo muaj nëntor, KLD përgatit një listë të kryetarëve të gjykatave që do të vlerësohen vitin e ardhshëm. Prioritet u jepet atyre kryetarëve që janë në fund të mandatit të tyre, ose që duan të ri-zgjidhen (neni 9). Inspektorati sapo ka filluar të mbledhë të dhëna mbi tre kryetarë gjykatash.

³⁶ GRECO Raundi i katërt i vlerësimit, Shqipëria 2014, paragrafi 73.

6. Lista e përhershme e vlerësimit/klasifikimit/pikëve

77. Sipas nenit 14 të Ligjit nr. 9877, datë 18 shkurt 2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", KLD-ja mban një listë të përhershme të "renditjes së gjyqtarëve" për "qëllim të karrierës profesionale", e cila përditësohet çdo gjashtë muaj. Të gjithë gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit vlerësohen sipas numrit të pikëve të marra nga numri 1 deri në numrin 361. Lista e renditjes që rrjedh nga ky sistem vlerësimi bëhet publike në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

78. Ky vlerësim i gjyqtarëve bëhet në përputhje me Vendimin nr. 269/2, datë 27/09/2010 "rregulla të detajuara për sistemin e renditjes së gjyqtarëve, i cili që është i detyrueshëm në rastin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve bosh në gjykatat e apelit dhe gjykatat e krimeve të rënda. Për caktimin e pikëve zgjidhet një grup pune i përbërë nga tre anëtarë për një vit.

79. Sipas Vendimit nr. 269/2, mund të arrihet rezultati maksimal prej 200 pikësh. Rezultati përkatës jepet mbështetur në kriteret e mëposhtme:

- 50% eksperiencia; eksperiencia në punë mund të çojë në marrjen e deri në 100 pikë: tre pikë jepen për çdo vit eksperiencë profesionale si gjyqtar, të cilat mblidhen në rezultatin maksimal prej 80 pikësh. Dy pikë të tjera shtesë caktohen për çdo vit eksperiencë profesionale si gjyqtar në gjykatën e apelit, të cilat mblidhen në rezultatin maksimal prej 20 pikësh.

- 40% rezultatet e vlerësimit; në këtë kategori mund të arrihen deri në 80 pikë. 80 pikët caktohen nëse gjyqtari merr vlerësimin "shumë mirë" në të tria kategoritë. Gjyqtari objekt vlerësimi merr 60 pikë për një vlerësim të përgjithshëm "shumë mirë". Megjithatë, dispozita në nenin 4 bie ndesh me këtë lloj matjeje rezultatesh, pasi në to përmenden katër seksione vlerësimi.

-10% aktiviteti shkencor dhe akademik, ku mund të arrihen deri në 20 pikë.

80. Përlllogaritja e nevojshme për të vërtetuar "aktivitetin shkencor dhe akademik" shpjegohet në detaje në Shtojcën që i bashkëlidhet vendimit. Një gjyqtar mund të marrë deri në 10 pikë për marrjen e një titulli akademik; 4 pikë për marrjen e një diplome masteri dhe 10 pikë për një doktoraturë. Për botimet, gjyqtari mund të marrë deri në 10 pikë për artikujt ligjorë, dhe deri në 5 pikë, 0,5 pikë për çdo artikull që mban autorësinë e tij/saj. Për çdo libër të botuar, ai/ajo merr 1,5 pikë; plus një pikë për ribotim. Në rast se kandidati ka botuar më shumë se tre libra, maksimumi i pikëve që mund të marrë është 10.

Për më tepër, gjyqtari objekt vlerësimi mund të marrë deri në 10 pikë nëse ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, ose anëtar i KLD-së. Për çdo pozicion të mbajtur, gjyqtari merr tre pike, por nuk mund të marrë më shumë se 10 pikë në total. Nga të tria seksionet, titujt akademikë, botimet dhe anëtarësimi, gjyqtari objekt vlerësimi nuk mund të marrë më shumë se 20 pikë në total.

7. Proceset disiplinore, Ministria e Drejtësisë

a. Inspektimet e Ministrisë së Drejtësisë

81. Ministri i Drejtësisë jo vetëm që është anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por është edhe përgjegjës për inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit lidhur me organizimin dhe performancën e tyre. MD-ja kryen po ashtu inspektime sipas programeve të veçanta tematike ose programeve territoriale, verifikon ankesat e depozituara nga qytetarët dhe nis procese disiplinore kundër gjyqtarëve në përputhje me nenin 31-35 e Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", Nr. 8811, datë 17.05.2001, ndryshuar nga Ligji Nr. 9448, datë

05.12.2005. Në këtë aspekt, ka një mbivendosje për verifikimin e ankesave me Inspektoriatin e KLD. Megjithatë, vetëm MD ka të drejtën të fillojë procedim disiplinor kundër gjyqtarëve.

b. Rregullat për procedurën disiplinore

82. Ligji Nr. 9877, datë 18. 02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, parashikon po ashtu rregulla për përgjegjësinë për shkeljet disiplinore, masat disiplinore dhe procedimin disiplinor kundër një gjyqtari” (Kreu V). Sipas nenit 33 (1), masat disiplinore jepet në përpjesëtim të drejtë me shkeljen e kryer. Masat disiplinore variojnë nga marrja e një vërejtjeje, vërejtjes me paralajmërim deri tek ulja e përkohshme në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët për një periudhë nga një deri në dy vjet, ose dërgimin për një deri në dy vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel, jashtë rrethit gjyqësor ku është emëruar gjyqtari, deri në shkarkimin nga detyra. Një gjyqtar mund të shkarkohet nga detyra nëse ai/ajo ka kryer një shkelje të rëndë të detyrave të ngarkuara, në përputhje me nenin 32 (d).

83. Sipas nenit 34 të ligjit nr. 9877, datë 18.02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të fillojë procedurën disiplinore në KLD kundër një gjyqtari. Të drejtat procedurale të gjyqtarit në fjalë parashikohen në nenin 35. Gjyqtari ka të drejtë të informohet për faktet për të cilat akuzohet, shkeljet e pretenduara, sanksionet e përcaktuara dhe për inspektorin të cilit i është caktuar çështja (neni 35 (1) a). Gjyqtari mund t’i formulojë pretendimet dhe kërkesat e tij/saj (neni 35 (1) b), mund të depozitojë prova dhe mund të ketë akses tek dokumentet e përdorura në procedimin disiplinor (neni 35 (1) c), si dhe mund të ndihmohet nga një koleg ose jurist gjatë procedimit (neni 35 (1)ç). Vendimi për shkarkimin nga detyra mund të apelohe në Gjykatën e Lartë. Për masa të tjera disiplinore, apelimi bëhet në Gjykatën e Apelit të Tiranës (neni 36).

c. Marrëdhënia ndërmjet Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Inspektoratit të KLD-së.

84. Fakti që si Ministria e Drejtësisë ashtu edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryejnë “inspektime” që vlerësojnë performancën dhe punën gjyqësore, dhe verifikojnë ankesat ndaj gjyqtarëve është kritikuar shpesh³⁷. Ndërmjet KLD-së dhe Ministrisë së Drejtësisë ka një Memorandum Mirëkuptimi për të shmangur mbivendosjen e kompetencave lidhur me inspektimin gjyqësor.

V. Analiza e situatës aktuale në Shqipëri

1. Perceptimi negativ për gjyqësorin

85. Diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me gjyqësorin në Shqipëri përmendin shpesh perceptimin negativ të gjyqësorit në sytë e publikut. Gjyqësori perceptohet shpesh si i korruptuar.³⁸ Për më tepër, marrja e vendimeve pretendohet se zgjat shumë dhe seancat gjyqësore ndonjëherë dëshmojnë për mangësi për mënyrën e realizimit të tyre. Gjyqtarët në Gjykatën e Apelit raportojnë se vendimet e gjykatës së shkallës së parë shpesh kanë cilësi të dobët dhe janë të vështira për t’u kuptuar. Një sistem i suksesshëm vlerësimi mund të ndihmojë në përmirësimin e punës së gjyqtarëve dhe të profesionalizimit të tyre. Vlerësimi mund të jetë hap i vogël që ndihmon në përmirësimin e perceptimit të gjyqësorit nga publiku dhe si rezultat në rritjen e besimit në sistemin gjyqësor.

2. Ngritja në detyrë dhe lista e përhershme e vlerësimit

86. Sipas eksperiencave të mia mbështetur në diskutimet personale, nuk është e qartë nëse gjyqtarët shqiptarë e kuptojnë mirë mënyrën sesi funksionon procesi i ngritjes në detyrë. Për më tepër, gjyqtarët shqiptarë duket se kanë mendim jo të mirë në lidhje me paanshmërinë e sistemit të emërimeve dhe ngritjes në detyrë. Në rast se ky perceptim është i saktë, ai mund të krijojë një ndjesi të përgjithshme mungese besimi, që e dëmton të gjithë gjyqësorin. Gjyqtarët duhet të vlerësohen jo

³⁷ GRECO Raundi i katërt i vlerësimit – Shqipëria 2014, paragrafi 101

³⁸ Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësisë, f. 11: GRECO Raundi i katërt i vlerësimit – Shqipëria 2014, paragrafi 4

vetëm në një mënyrë transparente e të ndershme, por duhet të mund të kenë besim se vlerësimet e mira e të merituar do të kenë efekt mbi ngritjet në detyrë në gjyqësor.

87. Sipas nenit 12 (4) dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 9877, datë 18. 02. 2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ngritja në detyrë duhet të mbështetet në rezultatet e listës së përhershme të renditjes. Lista e përhershme e renditjes duhet braktisur. Ka disa probleme me listën e përhershme të renditjes: së pari, nëse zbatohet siç duhet, lista e përhershme e renditjes duhet të dëshmojë se cili gjyqtar duhet të promovohet në çdo rast, pavarësisht nga pozicioni në diskutim. Megjithatë, për të gjetur kandidatin më të mirë të mundur, mund të jetë më mirë që të vlerësohet çdo kandidat në mënyrë individuale. Për shembull, eksperiencia të caktuara mund ta bëjnë që një kandidat të jetë një përzgjedhje më e mirë për një pozicion, sesa për një pozicion tjetër. Për shembull, një gjyqtar kandidatura e të cilit shqyrtohet për ngritje në detyrë si kryetari i gjykatës së krimeve të rënda duhet të ketë eksperiencë në fushën e krimeve të rënda. Një gjyqtar kandidatura e të cilit po shqyrtohet për një pozicion në gjykatë apeli nuk është e nevojshme të ketë eksperiencë të tilla. Megjithatë, nëse renditja në listën e përhershme të renditjes respektohet me skrupolozitet, nuk mund të ketë vend për analiza të tilla. Për pasojë, vendimet për ngritjen në detyrë nuk duhet të mbështeten vetëm tek lista e përhershme e renditjes.

88. Së dyti, lista vë shumë theks mbi vjetërsinë e gjyqtarit në punë. CCJE-ja³⁹ dhe Kombet e Bashkuara⁴⁰ theksojnë të dyja se gjendja e emërimeve dhe e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve nuk duhet të mbështeten vetëm tek eksperiencia në punë, por në kriteret objektive, në veçanti tek aftësia, integriteti dhe eksperiencia. Për pasojë, në përgjithësi nuk është e kundërshtueshme të merret parasysh vjetërsia në punë, ashtu siç merret nga sistemi i renditjes. Megjithatë, mbështetja në masë të madhe në vjetërsinë në punë, pengon sjelljen e gjyqtarëve të rinj, shumë të mirë, në pozicione ku mund të ketë nevojë për ide të reja për të përmirësuar gjyqësorin. Së treti, është e diskutueshme nëse aktiviteti akademik duhet të kontribuojë 10% të rezultatit, veçanërisht për shkak se vlerësimi merr parasysh aktivitetet akademike të gjyqtarit në nenin 17 të Vendimit 261/2 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”. Rëndësia e dyfishtë e aktiviteteve akademike të gjyqtarëve është kritikuar dhe në Raportin e Trajnimit të JuST-it, përgatitur nga Albana Boksi dhe Valbona Vata, në pikën 1.6, të hartuar sipas rekomandimit të gjyqtarëve pjesëmarrës.

89. Së katërti, lista e përhershme e renditjes i nenit 14 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9877, datë 18.02.2008 ka edhe probleme të tjera serioze: CCJE-ja, në Opinionin e saj nr. 17 (2014) paragrafi 42 dhe 43: ka rekomanduar shprehimisht që të mos prezantohet një renditje e përhershme e gjyqtarëve në Shqipëri:

42. CCJE-ja e konsideron po ashtu listën e detajuar të përhershme të renditjes së gjyqtarëve si rezultat të vlerësimit të tyre⁴¹ si të padëshirueshme. Një listë e tillë jo vetëm që të jep përshtypjen e gabuar për objektivitet dhe siguri, por edhe më keq akoma, ajo nuk është fleksibël dhe është e vështirë të ndryshohet pa u përfshirë në një ushtrim që i “liston sërish” të gjithë gjyqtarët e të njëjtit nivel. Kështu, ky sistem nuk është praktik dhe, në veçanti nëse bëhet publik, është i padrejtë. Ai nuk bën asgjë për të përmirësuar as efikasitetin e gjyqtarëve, dhe as pavarësinë e tyre.

43. Megjithatë, një sistem renditjeje për qëllime specifike, të tilla si ngritja në detyrë, mund të jetë i dobishëm. Për shembull, nëse dy ose më shumë gjyqtarë kanë aplikuar për ose po shqyrtohen për mundësinë e emërimit në një pozicion, ka të ngjarë që kandidatët të vihen në një lloj “renditjeje” për këtë qëllim.

³⁹Opinionin i CCJE-së 1(2001), para. 17 dhe 29; Opinionin 17(2014), para. 27.

⁴⁰Parimet Bazë të Pavarësisë së Gjyqësorit (1985), para. 13.

⁴¹Si në Shqipëri.

90. Për shkak të votimit të qartë kundër renditjes së përhershme, duhet të hiqet dorë nga lista e përhershme e renditjes e KLD-së. Kjo listë nuk është një hap drejt transparencës në gjyqësor. Në një takim personal me gjyqtarët, u shpreh mendimi se renditja publike e zhvlerëson autoritetin e gjyqtarit. Në të vërtetë është e vështirë të imagjinohet nëse palët në një proces gjyqësor të drejtuar nga gjyqtari i renditur në vendin e 361-të do ta pranonin autoritetin e dhe vendimin e gjyqtarit. Ka mundësi që pala humbëse ta apelojë vendimin thjesht dhe vetëm për perceptim të mungesës së kompetencës së gjyqtarit që është renditur jo mirë. Sistemet e renditjes mund t'i ndihmojnë konsumatorët që të zgjedhin midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve, p.sh. midis bankave apo restoranteve. Por, një qytetar nuk ka lirinë të zgjedhë gjyqtarin që vendos për çështjen e tij. Për më tepër, siç thekson CCJE, lista e renditjes jep një përshtypje të pavërtetë objektiviteti. Pa analizë të kujdesshme të sistemit të pikëve/renditjes, të cilën një qytetar nuk e bën dot sepse kërkon që më parë ta gjejë dhe ta kuptosh vendimin e KLD, lista e renditjes duket se i rendit gjyqtarët sipas meritës. Si rezultat një gjyqtar i renditur jo mirë do të perceptohet si një gjyqtar i keq, një gjyqtar i renditur në vendet e para do të duket si një gjyqtar i mirë. Meqenëse gjyqtarët e rinj nuk mund të mbledhin shumë pikë për vjetërsi në punë, dhe ndoshta nuk janë vlerësuar ende, ata domosdoshmërisht do të renditen keq. Megjithatë ky gjyqtar mund të punojë shumë dhe shumë mirë, një qytetar që shikon renditjen e tij në listë, do të mendojë që ai është një gjyqtar shumë i keq, vendimi i të cilit nuk është i besueshëm. Një gjyqtar i dënuar për një krim, p.sh. korrupsion, mund të vihet përpara përgjegjësisë në një seancë gjyqësore publike, me të drejtë. Përveç kësaj, qëllimi është të përmirësohet gjyqësori në përgjithësi, dhe jo të renditen publikisht gjyqtarët.

3. Vlerësimi nga Inspektorati i KLD-së

a. Konstatime të përgjithshme

91. Në përgjithësi, sistemi shqiptar i vlerësimit siç realizohet nga KLD-ja, dëshmon shumë aspekte që janë pozitive dhe që mund të ndihmojnë në përmirësimin e gjyqësorit shqiptar. KLD-ja duhet të vazhdojë punën e saj. Pas fazës së dytë të vlerësimit, vetë sistemi i vlerësimit duhet të vlerësohet me kujdes dhe të përmirësohet. Eksperienca e KLD-së duhet të merret parasysh me kujdes.

92. CCJE-ja rekomandon që elementët kryesorë të vlerësimit formal të parashikohen qartë dhe në mënyrë shteruese nga legjislacioni parësor.⁴² Në këtë kuadër, është mirë që baza e procesit të vlerësimit në Shqipëri të mbulohet nga legjislacioni parësor dhe që rregullat shtesë të zhvilluara nga KLD-ja të bëhen publike. Megjithatë, do të ishte e rekomandueshme që procesi të mbulohej në më shumë detaje nga legjislacioni parësor, siç sugjerohet nga projektligji për sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.

93. Ky sistem mund të mos jetë zgjidhja ideale për çdo sistem gjyqësor, sepse është shumë i ndërlikuar, po duket se ka avantazhe për sistemin shqiptar. Sistemi i vlerësimit në Shqipëri përfshin mjaft institucione të ndryshme, të tilla si KLD-në, Inspektoratin e KLD-së, kryetarët e gjykatave dhe Shkollën e Magjistraturës. Kjo e bën procesin më transparent dhe ndihmon në minimizimin e rrezikut real ose të perceptuar për korrupsion. Në Gjermani gjyqtarët vlerësohen nga kryetarët e gjykatave, ku zhvillojnë aktivitetin e tyre. Kryetarët e gjykatave janë gjyqtarë me shumë eksperiencë, në fund të karrierës së tyre. Megjithatë, për shkak të së shkuarës së Shqipërisë, do të ishte me vend që kryetarëve të gjykatave të mos u jepet rol më i madh në procesin e vlerësimit aktualisht. Së pari, kryetarët e gjykatave emërohen vetëm për disa vjet, dhe nuk janë në fund të karrierës së tyre, pra mund të jenë ende të rinj në moshë. Sipas pikëpamjeve të shprehura nga gjyqtarët gjatë takimeve personale, kryetarët e gjykatave kanë pasur pozicione shumë të forta në kohët e komunizmit. Për këtë arsye, nuk është konsideruar si i dëshirueshëm një rol më i madh i kryetarëve të gjykatave në procesin e vlerësimit. Megjithatë këto eksperiencë negative, nuk duhet ta mohojnë këtë metodë për të ardhmen. Është e dobishme të përftohet mendimi i një gjyqtari që i njehtësitë e gjyqtarit bazuar në eksperiencat e mbledhura në disa vite, dhe të mos mbështetemi vetëm tek inspektorët, që e

⁴² Opinioni 17 (2014) para. 30, rekomandimi 5 i CCJE-së.

vlerësojnë gjyqtarin nga një distancë. Pra, nëse eksperiencat bazuar në mendimin e kryetarit të gjykatës rezultojnë pozitive, roli i tyre mund të rritet në të ardhmen.

94. Duhet të theksohet po ashtu se raportet e vlerësimit të Inspektoratit të KLD-së duken të detajuara dhe të mbështetura në një analizë të kujdesshme dhe të thelluar. Kjo punë e vyer dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit duhet të përdoret më tej për të përmirësuar punën e gjyqtarit objekt vlerësimi dhe të gjyqësorit shqiptar në përgjithësi.

b. Koha e procesit të vlerësimit

95. Për sistemin e vlerësimit është disavantazh i madh që ai vlerëson punën e kryer nga gjyqtarët shumë kohë më parë⁴³. Në vitin 2012 dhe 2013, u vlerësuan vitet 2005-2006. Aktualisht, në vitin 2014, po vlerësohen vitet 2007-2009. Vlerësimi mund të ofrojë informacion të përfitueshëm për vendimet për ngritjen në detyrë dhe të japë informacionin e dobishëm për nevojat për trajnim të një gjyqtari vetëm nëse ai jepet në kohë. Prandaj, arsyet e vonës në procesin e vlerësimit duhet të analizohen me kujdes. Pastaj, duhet të ndërmerren hapat e nevojshme për t'i bërë vlerësimet në kohën e duhur. Në të shkuarën mund të ketë pasur faktorë të ndryshëm që kanë kontribuar për vonesat, ndërmjet të tjerash, siç u shpreh dhe në diskutimet personale, dhe mungesa e mbështetjes politike. Sapo Inspektorati i KLD e mori punën seriozisht, pas emërimit të Krye-Inspektorese aktuale, shpejtësia u rrit ndjeshëm⁴⁴. Megjithatë, vlerësimet nuk zhvillohen ende me shpejtësinë e duhur. Kjo gjithashtu, mund të shkaktohet nga arsye të ndryshme, përfshirë mungesën e burimeve, dhe nevojën për të vlerësuar shumë kritere të ndryshme, madje tepër, sipas rregullave të plogështa procedurale. Për më tepër, tani, inspektorët duhet të vlerësojnë midis 30 dhe 100 çështje për gjyqtar. Një pakësim i ndjeshëm (p.sh 20 çështje për gjyqtar), mund ta shpejtonte shumë procesin. Një tjetër arsye për vonesat mund të jetë rëndësia që i kushtohet në procesin e vlerësimit shkallës së kthimit të vendimeve të dhëna nga gjyqtarët objekt vlerësimi. Kjo kërkon përfundimin e procesit të apelit përpara se gjyqtari të vlerësohet për vendimin e tij. Në interes të afateve kohore për zhvillimin e procesit të vlerësimit, por gjithashtu edhe për arsyet e dhëna më poshtë në paragrafin 106-107, sugjerohet që nivelet e ndryshimit të vendimeve të mos përfshihet si kriter në procesin e vlerësimit.

c. Inspektorët

96. Duke pasur parasysh rekomandimet e CCJE-së⁴⁵ është pozitiv fakti që Inspektorati i KLD-së duhet të përbëhet nga gjyqtarë veçanërisht ata të cilët i kanë kualifikimet për të qenë gjyqtarë të gjykatave të apelit. Për momentin Inspektorati i KLD-së duket se ka vështirësi në gjetjen e kandidatëve të përshtatshëm. Me qëllim që të bëhet procesi i vlerësimit sa më efikas që të jetë e mundur, duhen bërë përpjekje të mëdha që të tërhiqen inspektorët më të mirë të mundshëm. Nga bisedat personale, ekspertja kuptoi se gjyqtarët e rinj jashtë Tiranës shpesh aplikojnë për t'u bërë inspektorë, me qëllim që të jetojnë në Tiranë. Sidoqoftë, gjyqtarët më të rinj nuk janë domosdoshmërisht inspektorët më të mirë. Ndërsa, ata me më shumë eksperiencë, gjyqtarët më të mirë, duhet të nxiten që të punojnë si vlerësues, me qëllim që të ndihmojnë të përmirësojnë gjyqësorin dhe të garantojnë që të ngrihen në detyrë gjyqtarë më të mirë. Ndoshta edhe ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë duhet të nxiten të përdorin eksperiencën e tyre me qëllim që të punojnë si inspektorë dhe të përmirësojnë gjyqësorin në përgjithësi. Me qëllim që të tërhiqen inspektorë të përshtatshëm, duhet të merren masat e nevojshme për ta bërë më tërheqës pozicionin e inspektorit. Për këtë duhet të përmirësohen kushtet e punës dhe opsionet e ardhshme për karrierë të inspektorëve. Për më tepër, meqenëse inspektorët kanë përgjegjësi të madhe për të ardhmen e gjyqtarit që është objekt vlerësimi, ata duhet të marrin trajnim fillestar shumë të mirë dhe mbështetje të mëpasshme. Mund të hartohet një manual për inspektorët, si Manuali "Procedurat e verifikimit të ankesave dhe të inspektimeve në

⁴³ GRECO Raundi i katërt i vlerësimit – Shqipëria 2014, paragrafi 75

⁴⁴ GRECO Raundi i katërt i vlerësimit – Shqipëria 2014, paragrafi 73; Fondacioni Slynn "Reforma e sistemit gjyqësor në Shqipëri – dokument për diskutim 2014, f.7.

⁴⁵ Opinioni 17 (2014) para. 37 i CCJE-së.

gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit”, botuar nga Euralius II në tetor 2012, me qëllim që të ndihmojë inspektorët në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit⁴⁶. Siç ka theksuar CCJE-ja, vlerësuesit kanë nevojë për kohë dhe burime të mjaftueshme për të kryer siç duhet detyrat e tyre.⁴⁷

97. Duhet të diskutohen me kujdes masat më të përshtatshme për të përmirësuar atraktivitetin e pozicionit për inspektorët. Për momentin, inspektorët gëzojnë statusin e gjyqtarëve të gjykatës së apelit. Kur mandati i tyre mbaron, inspektorët kthehen në pozicionet e mëparshme, zakonisht si gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë jashtë Tiranës. Kjo çon në një humbje të dyfishtë të statusit. Me qëllim që të shmangen vështirësi të tilla, Kreinspektorja ka sugjeruar që ish inspektorët të promovohen automatikisht në gjykata apeli pas përfundimit të mandatit. Megjithatë ngritja e garantuar në detyrë, në qoftë se shqyrtohet, duhet të prezantohet pas një vlerësimi të kujdesshëm të inspektorëve. Rregullat e përshtatshme për vlerësimin e inspektorëve janë aktualisht në diskutim⁴⁸. Është ftuar një anëtar i CCJE që të komentojë mbi draftin. Megjithatë, promovimi i garantuar nuk është domosdoshmërisht opsioni më i mirë, sepse një inspektor i mirë nuk bën detyrimisht një gjyqtar të mirë apeli.

d. Kriteret

98. Sipas Opinioni nr. 17 (2014) të CCJE-së, vlerësimi duhet të mbështetet në kritere objektive. Kriteret mund të përfshijnë tregues cilësorë, por dhe tregues sasiorë, megjithëse jo ekskluzivisht. Ato duhet t’i bëjnë të mundur vlerësuesit të vlerësojnë të gjitha aspektet që përbëjnë performancë të mirë gjyqësore.⁴⁹ Meqënëse vlerësimi ka për qëllim të përmirësojë gjyqësorin si një i tërë, si dhe besimin e publikut te gjyqësori, vlerësimi duhet të përqendrohet më shumë në aftësitë që i nevojiten gjyqtarit për t’i shërbyer publikut, se sa në arritjet akademike e skolastike. Kriteret e përdorura nga Komisioni britanik i Emërimeve në Gjyqësor (JAC/KEGJ) mund të ofrojë shtytje/informacion të vlefshëm në këtë drejtim⁵⁰. Integriteti i gjyqtarëve është sigurisht, një bazë e domosdoshme për besimin e publikut në gjyqësor. Shkelja e rregullave mbi integritetin duhet, megjithatë, të trajtohet fillimisht me procedura disiplinore. Për më tepër, gjyqtarët mund të edukohen dhe të inkurajohen që të krijojnë një mentalitet të integritetit dhe pavarësisë. Përveç kësaj, aftësitë e gjyqtarëve në organizimin e një seance gjyqësore të rregullt dhe efektive në sallën e gjyqit, dhe në hartimin e vendimeve të qarta dhe të kuptueshme janë me rëndësi parësore për të fituar besimin e publikut.

99. Vendimi nr. 261/2 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” përfshin kritere të shumta të ndara në tre seksione, të cilat lejojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të punës gjyqësore. Për më tepër, ka një Shtojcë që përfshin standardet që përcaktojnë sasinë e çështjeve të vendosura, nivelet e vendimeve të ndryshuara dhe afatet kohore përkatëse. Të gjitha këto kritere kërkojnë ca shpjegime për t’i kuptuar ato dhe domethënien e tyre në procesin e vlerësimit. Pas vlerësimit të kujdesshëm gjatë të dy raundeve të para të vlerësimit, kriteret mund të thjeshtësohen dhe të shmanget mbivendosja midis disa kritereve. Megjithatë, kjo mund të realizohet vetëm me përfshirjen e gjyqtarëve dhe të inspektorëve, duke përdorur eksperiencat e tyre dhe problemet specifike të sistemit gjyqësor shqiptar. Shembujt e mëposhtëm janë vetëm ide që kanë nevojë për diskutim të kujdesshëm. Për shembull, kriteret e parashikuara në nenin 7 dhe 8 mund të kombinohen në një nen. Neni 14 dhe 15 janë të vështira për t’u kuptuar pa shpjegime të mëtejshme. Dallimet ndërmjet nenit 11 “drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, orientimi i debatit gjyqësor duke u shprehur qartë”, dhe nenit 14 “aftësi komunikimi” mbivendosen lehtë. Kjo, pas shqyrtimit të kujdesshëm, mund të përmirësohet. Për shembull, seksioni I mund të reduktohet në “efektiviteti dhe përpikmëria në kohë”, duke përdorur kriteret aktuale të parashikuara në nenin 5, 7 dhe 8. Neni 7 dhe 8 mundësisht mund të përmbliidhen në një nen. Seksioni II mund të lihet siç është, me nenin 11 “aftësinë për drejtimin e një

⁴⁶ Fondacioni Slyn “Reforma e sistemit gjyqësor në Shqipëri – dokument për diskutim 2014, f.5.

⁴⁷ Opinioni 17 (2014) para. 36 i CCJE-së.

⁴⁸ Aftësitë organizative, metodologjia, integriteti dhe përkushtimi i inspektorëve duhet të vlerësohet sipas këtyre rregullave. Gjithashtu rregullat po diskutohen edhe në lidhje me mundësitë për të kundërshtuar një vlerësim të pafavorshëm..

⁴⁹ Opinioni 17 (2014) i CCJE-së, paragrafi 31-35, rekomandimi 6.

⁵⁰ Fondacioni Slyn “Reforma e sistemit gjyqësor në Shqipëri – dokument për diskutim 2014

procesi të rregullt gjyqësor”, nenin 6, “metodologjinë” dhe nenin 14 “aftësitë komunikuese” të shkruara në një nen. Aftësia për të menaxhuar një proces të rregullt ligjor dhe për të drejtuar debatin juridik kërkon aftësi komunikuese. Seksioni III duhet të vlerësojë sjelljen etike të gjyqtarit, pjesëmarrjen në kurse trajnimi dhe në aktivitete akademike.

100. Sipas raportit të trajnimit të JuST-it “Sistemi i vlerësimit dhe i inspektimit të gjyqtarëve në Shqipëri – përafrimi me standardet ndërkombëtare”, përgatitur nga Albana Boksi dhe Valbona Vata, gjyqtarët kanë kërkuar kriteret objektive dhe të qarta. Ata kanë kritikuar shumë nga kriteret e përdorura, duke thënë se shumë prej tyre nuk janë të qarta sa duhet, si për shembull “aftësia e gjyqtarëve për të shkruar thjesht dhe qartë”, “aftësia për të drejtuar dhe orientuar drejt debatin gjyqësor”, “disiplina në punë” dhe “solemniteti”.

101. Megjithëse është e pamundur që planifikohet paraprakisht vlerësimi i të gjitha aspekteve të punës optimale gjyqësore, do të ishte me vlerë nëse kriteret e përdorura nga Inspektorati I KLD-së do të mund të përcaktoheshin më konkretisht në të ardhmen, mbase duke përdorur shembuj praktikë. Për shembull, kriteri që gjyqtari duhet të jetë në gjendje “të shkruajë thjesht dhe qartë” mund të shpjegohet duke ju referuar përdorimit të saktë të gramatikës dhe të rregullave të shkrimit, si dhe kërkesës që vendimi duhet të ketë strukturë logjike dhe të jetë i kuptueshëm si për palët dhe për gjykatën e apelit. Inspektorët e Inspektariatit të KLD kanë krijuar gjatë punës së tyre praktika për interpretimin e termave abstrakte. Kjo lloj praktike duhet të publikohet që t’ju tregojë gjyqtarëve se çfarë kërkon prej tyre Inspektori i KLD. Për më tepër, këto praktika duhet të merren në konsideratë gjatë kurseve në Shkollën e Magjistraturës, për shembull mbi hartimin e akt-gjykimeve, me qëllim përmirësimin e gjyqësorit shqiptar në tërësi.

102. Akt-gjykimet e hartuara në një mënyrë të qartë dhe logjike, u mundësojnë palëve ndërgjyqëse – veçanërisht palës që ka humbur gjyqin – që ta kuptojnë vendimin e gjyqtarit. Edhe nëse palët nuk bien dakort me vendimin, është e rëndësishme që ata ta kuptojnë vullnetin e gjyqtarit të çështjes për t’i dëgjuar dhe për të shpjeguar arsyet e vendimit të tij. Një kuptueshmëri e tillë është vitale për besimin e personave që nuk janë pjesë e gjyqësorit në integritetin dhe aftësitë e tij. Pra, aftësia e gjyqtarit në shkrimin e akt-gjykimeve duhet të jetë me rëndësi të madhe në sistemin e vlerësimit në Shqipëri. CCJE-ja thekson rëndësinë e vendimeve gjyqësore me cilësi të lartë. Për pasojë, ajo beson se cilësia, jo vetëm sasia, e vendimeve të një gjyqtari duhet të qëndrojnë në zemër të vlerësimit individual. Për të vlerësuar cilësinë e vendimit të një gjyqtari, vlerësuesit duhet të përqendrohen tek cilësia që përdoret në punën e tij/saj të përgjithshme, dhe jo të vlerësojnë themelin e çështjes tek vendimet individuale.⁵¹ Sistemi shqiptar i vlerësimit i analizon vendimet gjyqësore të gjyqtarit objekt vlerësimi me kujdes, siç u tregua në takimin e organizuar me Kryeinspektoren dhe me Inspektoratin e KLD-së. Kryeinspektorja theksoi se inspektorët vlerësojnë, së pari, strukturën e një vendimi dhe nëse ai përmbush kërkesat e duhura procedurale. Së dyti, inspektori vlerëson strukturën logjike dhe cilësinë e vendimit. Së treti, kur vlerëson një vendim të kthyer mbrapsht (të ndryshuar), inspektori merr parasysh, nëse kthimi mbrapsht bazohej në kontradikta, apo në mungesën e logjikës. Për më tepër, gjuha e qartë dhe përdorimi i saktë i rregullave të shkrimit dhe të gramatikës përbëjnë faktor në procesin e vlerësimit. Në një diskutim personal, një gjyqtar nga gjykata e apelit e Tiranës komentoi se shumë gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë shkruajnë kaq keq saqë ishte e pamundur të kuptohet vendimi nga gjykata e apelit. Sipas eksperiencave të Fondacionit Slynn, gabimet ortografike dhe gramatika e keqe janë një tregues i qartë i mungesës së aftësive, si arsyetimi i logjikshëm dhe hartimi i akt-gjykimeve. Pra është me vend që sistemi aktual i vlerësimit gjyqësor në Shqipëri ta konsiderojë cilësinë e vendimeve të gjyqtarit si të rëndësishme në Seksionin II, neni 10 të vendimit 261/2. Megjithatë, cilësia e arsyetimit të vendimeve ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Trajnimi i duhur praktik në hartimin e akt-gjykimeve duhet të ofrohet tek Shkolla e Magjistraturës, si për studentët, ashtu edhe për ata gjyqtarë për të cilët kjo ishte një dobësi, sipas vlerësimit. Ndoshta

⁵¹ Opinioni 17 (2014) para, 35 i CCJE-së. Shih Opinioni 11 (2008) para. 57 të CCJE-së.

mund të ftohen edhe njerëzit që nuk janë profesionistë të gjyqësorit, për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me kuptueshmërinë e akt-gjykimeve.

103. Drejtësia nuk duhet vetëm të jepet me cilësi të lartë, por edhe brenda afateve të arsyeshme, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës së Shqipërisë. Raporti i OSBE-së i vitit 2012 “Drejt drejtësisë – analiza e proceseve civile në gjykatat e rrethit” trajton kuadrin ligjor si dhe situatën aktuale lidhur me vonesat në sistemin gjyqësor shqiptar. Ligji shqiptar jep udhëzime lidhur me faktin sesa shpejt mund të arrijë të përfundojë një çështje. Sipas seksionit I, Vendimit 261/2, produktiviteti dhe efektiviteti i gjyqtarit vlerësohet si pjesë e vlerësimit të tij profesional.

104. Faktorë sasiorë, të tillë si numri i çështjeve për të cilat gjyqtari është shprehur me vendim, ose norma/përqindja e zgjidhjes së çështjeve (CR) mund të jetë faktor i rëndësishëm për vlerësimin e gjyqtarëve. Ka mënyra të ndryshme në të cilat mund të përdoren tregues të tjerë sasiorë për të vlerësuar efektivitetin e gjyqtarit. Për shembull, numri i çështjeve për të cilat gjyqtari është shprehur me vendim mund të krahasohet me numrin mesatar të çështjeve të përfunduara nga gjyqtarë të tjerë në pozicion të ngjashëm. Një faktor tjetër mund të jetë dhe fakti nëse një gjyqtar i përmbush shifrat e caktuara nga gjykata të cilat përfaqësojnë objektiva specifike. Për më tepër, mund të shqyrtohet numri i çështjeve për të cilat gjyqtarit i është dashur më shumë kohë sesa afati ligjor kohor i parashikuar për të marrë vendim për çështjen. Megjithatë, këto lloj kriteresh duhet të trajtohen gjithnjë me kujdes. CCJE mbështet pikëpamjen që efikasiteti i një gjyqtari duhet të merret parasysh në vlerësimin profesional të tij/të saj. Megjithatë CCJE thekson që cilësia e drejtësisë të mos kuptohet thjesht si një sinonim “i produktivitetit”⁵². Së pari, afatet kohore dhe ngarkesa vjetore e punës, e parashikuar, duhet të jenë realite dhe të drejta, duke marrë parasysh të drejtat dhe sjelljen e palëve ndërgjyqëse, si dhe kushtet e punës dhe ndërlikimet në fusha ligjore. Për shembull, krimi i jakave të bardha zakonisht kërkon më shumë kohë sesa çështjet e thjeshta që kanë të bëjnë me vjedhje dyqanesh, kështu që do të ishte e padrejtë të matej numri i çështjeve që kanë të bëjnë me vjedhje dhe për të cilat gjyqtari është shprehur me vendim me numrin e vendimeve të marra nga një gjyqtar që merret me krimin e jakave të bardha. Shumë gjyqtarë në Shqipëri vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë e afateve ligjore.⁵³ Gjithsesi, vihet re se inspektorët e KLD-së mundohen të mos e zbatojnë Shtojcën 1 shumë rigorozisht, por të marrin parasysh rrethanat individuale të secilës çështje.

105. Për më tepër, CCJE-ja paralajmëron se mbështetja shumë tek produktiviteti ose norma e zgjidhjes së çështjeve nga gjyqtari (CR) është problematike, pasi mund të çojë në stimuj të rremë.⁵⁴ Për shembull, gjyqtarët mund të kenë tendencë të punojnë vetëm me çështje të lehta dhe të reja, dhe jo me çështje të vështira, të cilat përgjithësisht janë të vjetra dhe shkaktojnë shpesh stok çështjesh të mbartura. Po ashtu, gjyqtarët mund të jenë të predispozuar ta ndajnë një çështje në një ose më shumë çështje për të dhënë dy vendime, ndërkohë që një vendim do të ishte i mjaftueshëm. Pas përfundimit të raundit të dytë të vlerësimit, sistemi aktual i vlerësimit duhet të vlerësohet me kujdes, duke marrë parasysh si eksperiencat e Inspektoratit të KLD-së dhe të gjyqtarëve për t’u siguruar se kriteret sasiorë mund të japin kontribute të rëndësishme dhe të vyera për produktivitetin e gjyqtarit.

106. CCJE-ja bën thirrje që vlerësimi të mos mbështetet vetëm mbi kriteret sasiorë dhe statistika (për shembull, vetëm tek norma e zgjidhjes së çështjeve dhe përqindja e çështjeve të ndryshuara).⁵⁵ Për

⁵² CCJE, Opinioni 17 (2014), paragrafi 31; CCJE, Opinioni 1 (2005), paragrafi 25.

⁵³ Raporti i OSBE-së i vitit 2012 “Drejt drejtësisë– Analizë e proceseve civile në gjykatat e rrethit” S. 32; Raport trajnimi i JUST-it “Sistemi i vlerësimit dhe inspektimit të gjyqtarëve në Shqipëri. Përafrimi me standardet ndërkombëtare”, përgatitur nga Albana Boksi dhe Valbona Vata (rekomandimi 1.2; 1.4).

⁵⁴ Opinioni 17(2014), para. 34 i CCJE-së.

⁵⁵ Opinioni 17 (2014) para. 31-35, rekomandimi 6 i CCJE-së.

më tepër, CCJE-ja,⁵⁶ Rekomandimet e Kievit⁵⁷ dhe Raporti i ENCJ-së⁵⁸ paralajmërojnë se të mbështeturit e vlerësimit tek përqindja e çështjeve të ndryshuara nga apeli është problematike, përveçse kur shifra dhe mënyra e ndryshimeve dëshmojnë qartë mungesën e njohurive mbi të drejtën dhe procedurën nga gjyqtari. Pra, është pozitive që në Shqipëri vlerësimet nuk mbështeten vetëm tek kriteret sasiore, megjithëse ato luajnë rol të rëndësishëm në Seksionin I. Megjithatë, të mos mbështetesh fare në përqindjen e vendimeve të kthyer/ndryshuara do t'i mundësonte inspektoriatit të KLD të bënte vlerësimet më në kohë. Në përgjithësi, metodologjia që përdor një gjyqtar, dhe jo çështja nëse vendimi i tij kthehet për ndryshim nga gjykata e apelit, duhet të jetë vendimtare në një vlerësim. Në një sistem gjyqësor pa precedente të detyrueshme, siç është sistemi shqiptar, gatishmëria e një gjyqtari për ta sjellë një çështje të vështirë përpara gjykatës së apelit, duke rrezikuar kthimin/ndryshimin e vendimit, mund të jetë e vlerësueshme dhe jo një e metë që duhet kritikuar në një vlerësim.

107. Jo vetëm afatet kohore dhe ngarkesa e punës, por edhe treguesi i nivelit të rrëzimit të çështjeve në Shtojcën 1 duhet të kontrollohet në mënyrë të rregullt për të parë se sa të përshtatshme janë ato. Shkalla e kthimit (të çështjeve) nuk duhet të përbëjë më shumë sesa rregullin e përgjithshëm, dhe duhet të aplikohet me kujdes duke pasur parasysh rrethanat individuale të secilës çështje, si, për shembull, duhet parë nëse vendimi i një gjyqtari është kthyer për shqyrtim për shkak të një ligji të paqartë, ligji të ri, apo për shkak të një gabimi të madh në zbatimin e së drejtës procedurale. Këto rregulla duhet të mblidhen dhe të botohen për të siguruar një proces transparent vlerësimi.

108. Transparenca e proceseve gjyqësore përbën aspekt të rëndësishëm të sistemit gjyqësor në një shtet demokratik.⁵⁹ Aftësitë organizuese të gjyqtarit, sjellja në seancat gjyqësore, dhe vullneti për të dëgjuar me kujdes palët në proces, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, jo vetëm për një proces gjyqësor efikas, por gjithashtu për perceptimin e qytetarëve të thjeshtë mbi sistemin gjyqësor në tërësi. Neni 11 dhe neni 14 i Vendimit 261/2 merren me aftësitë e gjyqtarit objekt vlerësimi për të realizuar një proces të rregullt, të kuptueshëm dhe efektiv gjyqësor. Megjithatë, për aq sa e ka kuptuar ekspertja sistemin shqiptar të vlerësimit, inspektorët zakonisht nuk shkojnë për të vizituar seancat gjyqësore të organizuara nga gjyqtarët që janë objekt vlerësimi. Pra, çështja nëse inspektorët arrijnë të kuptojnë në mënyrën e duhur se si sillen një gjyqtar gjatë seancave gjyqësore mbetet në pikëpyetje. Gjyqtarët e pyetur për mendimin e tyre për këtë pikë u shprehën se ishin dakord që kjo përbën aspekt të rëndësishëm dhe se vizitat në disa seanca gjyqësore të gjyqtarit objekt vlerësimi mund të jenë të dobishme për inspektorët. Regjistrimet audio të bëra gjatë seancave mund të përdoren gjithashtu në këtë proces vlerësimi. Megjithatë, eksperti mendon se përshtypja e duhur se si sillen gjyqtari në sallën e gjyqit mund të përftohet vetëm duke marrë parasysh të gjitha aspektet e komunikimit të tij verbal dhe non-verbal. Prandaj rekomandohet të bëhen vizita personale në sallën e gjyqit.

109. Në këtë kuadër, mund të jetë e dobishme po ashtu që të mos punohet vetëm me aftësitë organizative dhe komunikuese të kryetarit të trupit gjykues, por të shihet edhe nëse ai/ajo i organizon seancat e gjyqit në zyrë, apo në sallën e gjyqit. Organizimi i seancave gjyqësore në sallat e gjyqit është parakusht i rëndësishëm për seancat me dyer të hapura, dhe, për pasojë, për një proces transparent ligjor.⁶⁰ Në Vendimin e saj 238/1/b, datë 24.12.2008, KLD-ja ka vendosur që seancat gjyqësore mund të organizohen në zyrën e gjyqtarit vetëm në rast se nuk ka salla të mjaftueshme gjyqi. Megjithatë, sipas informacionit të JuST-it, pjesa më e madhe e gjykatave aktualisht i ka pajisjet e nevojshme teknike për të planifikuar me efektivitet seancat dhe për të rezervuar sallat e gjyqit. Pra, mund të jetë me vend të inkurajohen gjithnjë e më shumë gjyqtarët të përdorin sallat e gjyqit në

⁵⁶ Opinioni 17(2014) para. 35 i CCJE-së; shih po ashtu Opinionin 11(2008), para. 74 të CCJE-së dhe Opinionin 6 (2004) para. 36 të CCJE-së.

⁵⁷ Shih Rekomandimet e Kievit (2010), para. 28.

⁵⁸ Shih Raportin e ENCJ-së për periudhën 2012-2013, seksion 4.12.

⁵⁹ Raporti i OSBE-së i vitit 2012 "Drejt drejtësisë— Analizë e proceseve civile në gjykatat e rrethit", Kreu II.

⁶⁰ Raporti i OSBE-së i vitit 2012 "Drejt drejtësisë— Analizë e proceseve civile në gjykatat e rrethit" S. 80-81, 87.

dispozicion të gjykatave duke e marrë parasysh këtë faktor në vlerësimin e tyre. Në gjykatat ku nuk ka një numër të mjaftueshëm sallas gjyqi, duhen bërë përpjekje të mëdha për të siguruar një numër të mjaftueshëm sallas gjyqi.

110. Për më tepër, Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 „Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve “ ka përcaktuar në nenin 13, 14 detyrën e gjyqtarëve për t’i ftuar palët të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet ndërmjetësimit. Mund të jetë e dobishme që në të ardhmen të merret parasysh gatishmëria e gjyqtarit për t’i ftuar palët të përdorin ndërmjetësimin, jo sistemin gjyqësor, gjatë procesit të vlerësimit gjyqësor (për të).

Një set i thjeshtëzuar kriteresh, mund të ishte si më poshtë:

- **Seksioni I efikasiteti dhe përpikmëria në kohë**
- Sasia (duke përdorur numrin e vendimeve, normën e zgjidhjes së çështjeve)
- Përpikmëria në kohë (duke përdorur vendimet dhe kalendarin/planifikimin e seancave gjyqësore)
- **Seksioni II aftësitë profesionale dhe të komunikimit**
- Aftësia për të hartuar vendime me cilësi të lartë (duke përfshirë vendimet e ndryshuara, nëse bazohen në gabime të rënda ligjore dhe procedurale)
- Metodologjia; Aftësia për të organizuar dosjet dhe senacat gjyqësore, transferimi i çështjeve për ndërmjetësim, nëse e nevojshme.
- Aftësitë e komunikimit gjatë seancave gjyqësore
- **Seksioni III etika dhe përkushtimi**
- Etika e gjyqtarit dhe disiplina në punë
- Pjesmarrja e gjyqtarit në aktivitete trajnimi
- Puna e gjyqtarit si akademik ligjor

e. Pasojat e vlerësimit

111. Sipas objektit të sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve në Shqipëri, siç parashikohet në ligj, vlerësimi duhet të ndihmojë për të përcaktuar nevojat e një gjyqtari për trajnim. Për pasojë, është e rëndësishme që Inspektorati i KLD-së t’i komunikojë përshtypjet për mangësitë e gjyqtarit të vlerësuar tek Shkolla e Magjistraturës, në mënyrë që të mund të zhvillohen instrumente efektive trajnimi. Po ashtu, mund të jetë e dobishme që gjyqtarët që dëshmojnë nevoja specifike për trajnim, veçanërisht gjyqtarët e vlerësuar me „pranueshëm“ ose „i paaftë“ duhet të marrin rekomandime specifike për të marrë pjesë në trajnime specifike për të korrigjuar mangësitë e tyre. Në të kundërtën, rivlerësimi një vit më pas mund të mos ketë efektet e dëshiruara.

112. Sipas Opinionit nr. 17 (2014) paragrafi 29, 44, i rekomandimit 12 të CCJE-së, në rrethana përjashtimore, gjyqtari mund të shkarkohet nga detyra në rast se vlerësimi tregon se ai/ajo nuk është i aftë ose i gatshëm të kryejë detyrat deri në një standard të arsyeshëm, pas një gjykimi objektiv. Megjithatë, në këtë rast duhet të ekzistojnë dhe të respektohen me rigorozitet garancitë procedurale. Sipas nenit 13, të vlerësuarit si “i paaftë” përbën arsye për të nisur procedurat për shkarkimin e një gjyqtari. Neni 13 nuk reflektohet në nenin 32, 33, megjithatë nuk është tërësisht e qartë nëse “procedura e shkarkimit” e përmendur këtu nënkupton procedurën disiplinore të trajtuar në Kreun V të ligjit. Për pasojë, nuk është e qartë se çfarë garancish procedurale ekzistojnë në këtë situatë. Kjo situatë duhet të ndreqet. Po ashtu, duhet të kontrollohet nëse vetëm gjyqtarët e vlerësuar si “të paaftë” mund të shkarkohen sipas standardit strikt të CCJE dhe ENCJ⁶¹.

f. Të drejtat e gjyqtarit pjesëmarrës

⁶¹ Çdo veprim për të hequr një gjyqtar të paaftë apo të korruptuar duhet të përputhet me standartet e larta të vendosura nga parimi i mos-heqjes së gjyqtarëve, pavarësia e të cilëve duhet të mbrohet.”. Raporti 2013-2014 i Rrjetit Evropian të Këshillëve për Gjyqësorin mbi pavarësinë dhe llogaridhënien e Gjyqësorit, f. 59.

113. CCJE-ja thekson rëndësinë e mbrojtjes në mënyrën e duhur të të drejtave të gjyqtarit objekt vlerësimi.⁶² Për pasojë, është e rëndësishme që gjyqtari i vlerësuar të mund të shprehë mendimet e tij/saj në një vetëvlerësim, në një intervistë me inspektorin, dhe më pas të shprehet përpara se të merret vendimi nga KLD. Ashtu siç u shpjegua në takim me Kryeinspektoren, KLD-ja është e hapur ndaj argumenteve të gjyqtarëve dhe i modifikon projekt-raportet e saj herë pas here. Megjithatë, për ta vlerësuar këtë fakt më në detaj do të ishte i nevojshëm më shumë informacion mbi arsyet e dhëna për vendimet e KLD.

114. Më tej, mbështetur në rekomandimet e CCJE-së,⁶³ gjyqtari objekt vlerësimi duhet të ketë të drejtën që të kërkojë zëvendësimin e inspektorit vlerësues, i cili mund të perceptohet objektivisht si i njëanshëm. Inspektori ka një përgjegjësi të madhe kur vlerëson një gjyqtar. Dhënia e mundësisë që gjyqtari të kërkojë, për arsye të shëndosha, zëvendësimin e inspektorit, mund të rrisë besimin e gjyqtarit në sistemin e vlerësimit.

115. Më tej, rishikimi gjyqësor kundër vendimeve të KLD-së është i mundshëm në Shqipëri Kjo zgjidhje është bindëse pasi vlerësimi gjyqësor në Shqipëri mund të ketë pasoja serioze mbi rritjen e shanseve për ngritje në detyrë, deri tek shkarkimi nga detyra. Po ashtu, neni 6 i KEDNj-së kërkon rishikimin efektiv. Megjithatë, rregullat procedurale mbi rishikimin gjyqësor të vendimeve nga KLD janë të paqarta. Pra, rregulla të qarta për të drejtën për rishikim gjyqësor dhe rregullat procedurale të zbatueshme duhet të parashikohen qartë në legjislacionin parësor shqiptar.

3. Vlerësimi informal, arsimit ligjor vazhdues

116. Shkolla e Magjistraturës është një aset që duhet të përdoret dhe të zhvillohet më tej për të përmirësuar cilësinë e gjyqësorit shqiptar. Kurse të nivelit të lartë nevojiten për të arritur këtë qëllim Drejtori i Shkollës së Magjistraturës theksoi në një takim të organizuar me të se Shkolla ka për qëllim të ofrojë kurse për lëndë që vlerësohen si të dobishme nga gjyqtarët. Kjo qasje duhet të ndiqet dhe zhvillohet më tej. Siç u tha më lart, eksperiencat e Inspektoriatit të KLD duhet të përdoren në kurse trajnimi për të trajtuar në mënyrë të veçantë mungesat në njohuritë dhe aftësitë e gjyqtarëve. Kurset nuk duhet të synojnë vetëm në përmirësimin e njohurive ligjore për të drejtën substantive, por edhe për të drejtën procedurale, por duhet të ofrojnë trajnim në lidhje me aftësitë që nevojiten për të ushtruar profesionin e një gjyqtari. Ato duhet të ofrojnë këshilla praktike mbi çështje të tilla si: 'Si të organizojmë një seancë në mënyrë efikase?' ose 'Si të hartojmë një akt-gjykim të qartë dhe bindës?' Në Gjermani kurset ofrohen në bashkëpunim me psikologë për çështje të tilla si: 'Si ta vlerësojmë besueshmërinë e një dëshmitari?' Kuse të tilla do të ishin me dobi edhe për Shqipërinë. .

117. CCJE sugjeroi se analiza/vlerësimi nga kolegët dhe komentet/dhënia e mendimeve midis gjyqtarëve mund t'i ndihmojnë gjyqtarët në punën e tyre⁶⁴. Mjete të tilla vlerësimi informal si analiza/vlerësimi nga kolegët dhe komentet/dhënia e mendimeve midis gjyqtarëve nuk përdoren në Shqipëri. Në bisedë private, ekspertit ju tha se gjyqtarëve u pëlqejnë diskutimet midis kolegëve, veçanërisht kur marrin pjesë në kurse tek Shkolla e Magjistraturës. Të metat në performancën gjyqësore duhet të trajtohen jo vetëm me kërcënimin e një vlerësimi të pafavorshëm, por gjithashtu me anë të shkëmbimit të praktikës më të mirë dhe analizën/vlerësimin midis kolegëve në baza vullnetare të besimit të ndërsjellë. Këto instrumente mund të jenë të dobishme sepse ato e ndajnë procesin e të nxënimit nga procesi i vlerësimit, i cili mund të përjetohet si stresant dhe mosbesues. Veçanërisht gjyqtarët e rinj mund të përfitojnë nga kontributi i kolegëve më me eksperiencë. Për shembull, në Austri, ka nisur një projekt për rishikimin e punës së gjyqtarëve nga kolegët nga Shoqatat e Gjyqtarëve Austriakë. Gjyqtarët që marrin pjesë në projekt mund të vizitojnë në mënyrë vullnetare seancat e njëri-tjetrit për të dhëna këshilla dhe komente informale mbi bazën e besimit të ndërsjellë. Këto instrumente mund të jetë të dobishme veçanërisht për të përmirësuar aftësinë e

⁶² Opinioni 17(2014) para. 41, rekomandimi 11 i CCJE-së.

⁶³ Opinioni 17 (2014) para. 36 i CCJE-së

⁶⁴ CCJE, Opinioni 17 (2014), paragrafi 25.

gjyqtarit për organizimin e seancave gjyqësore, gjë e cila konsiderohet e rëndësishme në nenin 11, 14, Vendimi 261/2. Për më tepër, komentet ndërmjet kolegësh mund të jenë të dobishme pasi ata e ndajnë procesin e të nxënit nga procesi i vlerësimit, i cili mund të përjetohej si stresues dhe mosbesues. Në raportet ndërkombëtare, problemet në organizimin e seancave gjyqësore janë identifikuar si probleme kryesore në gjyqësorin shqiptar.⁶⁵ Sidoqoftë, futja në përdorim e këtyre instrumenteve me ligj mund të krijojë vështirësi, meqenëse mund të ketë një mungesë besimi midis gjyqtarëve. Megjithatë, besimi i ndërsjellë dhe vullnetarizmi janë thelbësorë për futjen me sukses në përdorim të instrumenteve të tilla. Një mënyrë premtuese mund të jetë futja nëpërmjet një projekti pilot në një gjykatë të vogël, organizuar nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, ose gjatë kurseve tek Shkolla e Magjistraturës.

4. Procedurat disiplinore

118. Situata e dy inspektorateve një në Ministrinë e Drejtësisë dhe një në KLD me kompetenca të mbivendosura, siç parashikohet në nenin 16 a-ç dhe 31-35 të Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", Nr. 8811, datë 17.05.2001, ndryshuar nga Ligji nr. 9448, datë 05.12.2005, është diskutuar dhe kritikuar shpesh. Në fuqi është një memorandum që u bën thirrje të dyja inspektorateve që të bashkëpunojnë. Megjithatë, në kuadrin afatgjatë, përgjegjësitë duhet të rregullohen më qartë dhe inspektorët të përqendrohen tek KLD-ja, për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit. Po ashtu, përderisa është e rëndësishme që proceset disiplinore dhe vlerësimi gjyqësor të mbahen në parim veçmas, si rregullat e zbatueshme ashtu dhe personat që i zbatojnë këto rregulla duhet të organizohen në degë të veçanta të KLD-së. Përpara se të bihet dakord për një reformë të tillë bazë, KLD-ja dhe MD-ja duhet të kenë të drejtën e fillimit të procedurave disiplinore.

VI. Rekomandimet

1. Republika e Shqipërisë duhet të synojë përmirësimin e sistemit të saj gjyqësor për të ofruar shërbimet gjyqësore të nivelit më të lartë të mundshëm. Vlerësimi individual i gjyqtarëve, por edhe arsimit ligjor i vazhdueshëm dhe procedimet disiplinore duhet të përdoren për ta arritur këtë objektiv në interes të qytetarëve shqiptarë.
2. Raundi i dytë i vlerësimeve duhet të përfundohej nga KLD-ja.
3. I gjithë sistemi i vlerësimit, përfshirë dhe kriteret e përdorura, duhet të vlerësohen me kujdes. Eksperiencat e Inspektoratit të KLD-së dhe eksperiencat e gjyqtarëve duhet të përdoren për të përmirësuar si procesin e vlerësimit, ashtu edhe gjyqësorin shqiptar në tërësi.
4. Eksperiencat e Inspektoratit të KLD-së duhet të përdoren për të vlerësuar me kujdes nevojat dhe mangësitë e trajnimit të gjyqtarëve. Gjyqtarët duhet të kenë mundësinë që të ndreqin me efektivitet mangësitë e zbuluara në vlerësim. Gjyqtarët duhet të inkurajohen të studiojnë me kujdes vlerësimet për ta dhe të mësojnë prej tyre. Gjyqtarët mund të ftohen po ashtu të marrin pjesë në kurse specifike trajnimi në Shkollën e Magjistraturës.
5. Pasi të jenë identifikuar nevojat dhe mangësitë për trajnim nga Inspektorati i KLD-së, si dhe nga raportet ndërkombëtare, duhet të diskutohet përmirësimi i kurrikulës së Shkollës së Magjistraturës si dhe prezantimi i mjeteve informale për përmirësimin e punës gjyqësore, të tilla si komentet ndërmjet kolegëve.
6. Lista e përhershme e renditjes duhet të shmanget, ose të paktën të hiqet nga faqja kryesore e KLD-së në internet.
7. Në të ardhmen, duhet të parashikohen qartë në legjislacionin parësor elementët kryesorë të vlerësimit gjyqësor, duke përfshirë dhe kriteret e zbatueshme.

⁶⁵ 2012 Raporti i OSBE {Drejt Drejtësisë- Analizë e proceseve gjyqësore në gjykatat e rrethit"

8. Aktualisht, Inspektorati i KLD-së i vlerëson gjyqtarët duke përdorur një numër të madh kriteresh abstrakte në të tria seksionet, që janë të vështira për t'u kuptuar. Pas vlerësimit me kujdes në dy raundet e para të vlerësimit, kriteret mund thjeshtohen. Megjithatë, kjo punë mund të bëhet vetëm me përfshirjen e gjyqtarëve dhe të inspektorëve, duke përdorur eksperiencat e tyre. Për shembull, Seksioni I mund të reduktohet në "efektiviteti dhe përpikmëria në kohë", duke përdorur kriteret aktuale në nenet 5, 7 dhe 8. Nenet 7 dhe 8 mundësisht mund të përmbliidhen në një nen të vetëm. Seksioni II mund të qëndrojë siç është, me nenin 11 "aftësia për të drejtuar një proces të rregullt gjyqësor", nenin 6, "metodologjia" dhe nenin 14 "aftësitë komunikuese" të shkruara në një nen. Aftësia për të "drejtuar një proces të rregullt gjyqësor" dhe "për të orientuar debatin gjyqësor" kërkon aftësi komunikuese. Seksioni III mund të vlerësojë sjelljen etike të gjyqtarit, pjesëmarrjen e tij në kurse trajnimi dhe aktivitete akademike.

9. Pas një vlerësimi të kujdesshëm të eksperiencave të Inspektoratit të KLD-së, nëse është e mundur, kriteret tilla abstrakte, të tilla si "aftësia për të shkruar qartë", ose "metodologjia" në nenin 6, "solemniteti dhe disiplina në punë" në nenin 15 duhet të shpjegohen më tej duke përdorur shembuj.

10. Gjyqtarët duhet të vlerësohen mbështetur në një grup të mirëbalancuar treguesish sasiorë dhe cilësorë që lejojnë vlerësimin e kualifikimeve, integritetit, aftësisë dhe efektivitetit të tyre. Ashtu siç bëhet nga sistemi shqiptar, vlerësimi nuk duhet të bazohet vetëm tek të dhënat statistikore. Të shkruarit e akt-gjykimeve të qarta, të arsyetuara mirë dhe aftësia për të zhvilluar seanca gjyqësore efektive dhe të paanshme duhet të jetë në qendër të vlerësimit.

11. Kriteret e përcaktuara në Shtojcën 1 duhet të analizohen me kujdes për t'u bërë të mundur vlerësuesve të vlerësojnë në thellësi efektivitetin e gjyqtarit. Përpikmëria në kohë dhe ngarkesa e parashikuar vjetore duhet të jetë realiste dhe e drejtë, duke marrë parasysh të drejtat e palëve si dhe kushtet e punës, si dhe komplikimet në fusha të caktuara ligjore. Duhet të shmangen stimujt e rremë, të tillë si përqendrimi tek "çështjet e thjeshta" për të prodhuar një numër të lartë vendimesh.

12. Sjellja e gjyqtarit në seancat gjyqësore përbën faktor të rëndësishëm për një sistem transparent dhe të vlerësueshëm ligjor. Për pasojë, vlerësimet duhet të marrin parasysh mënyrën sesi gjyqtari i organizon seancat gjyqësore dhe mënyrën sesi ai është në gjendje të drejtojë debatin ligjor në një seance gjyqësore. Për të vlerësuar me efektivitet aspekte të tilla të rëndësishme, vlerësuesit duhet të marrin pjesë në seancat gjyqësore të organizuara nga gjyqtarët objekt vlerësimi.

13. Në vlerësimet e ardhshme mund të merret parasysh përdorimi i sallave të gjyqit dhe referimi i çështjeve të përshtatshme për ndërmjetësim nga kryetari i trupit gjykues.

14. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të botojë udhëzime dhe shembuj mbështetur në vendimet e tij të mëparshme, duke shpjeguar sesi ai i kupton kriteret të caktuara për ta bërë më të thjeshtë për gjyqtarët të kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre. Kjo mund të përmirësojë si performancën gjyqësore të gjyqtarëve dhe besimin e tyre për punën e bërë nga Inspektorati i KLD-së.

15. Procesi i vlerësimit duhet të bëhet më në kohë. Në të shkuarën, gjyqtarët janë vlerësuar për performancën e para shumë viteve. Vlerësimi mund të ofrojë informacion të përditësuar për vendimet për ngritjen në detyrë dhe të japë kontribut dhe informacion të dobishëm për nevojat për trajnim për gjyqtarin, vetëm nëse ai bëhet në kohë. Në mënyrë që vlerësimi të bëhet në kohë, përqindjes së vendimeve të ndryshuara të çështjeve duhet t'i jepet më pak rëndësi ose të mos përdoret më.

16. Duhet të qartësohen kriteret dhe rregullat procedurale në Ligjin nr. 9877 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" mbështetur në të cilat mund të shkarkohet nga puna

një gjyqtar i vlerësuar si “i paaftë”. Për më tepër, duhet të vlerësohen me kujdes nëse standartet strikte të Opinionit të CCJE nr. 17 (2014) për pushimin e një gjyqtari nga puna respektohen me ligj.

17. Duhet të ketë rishikim gjyqësor kundër vendimeve të KLD. Në legjislacionin parësor duhet të jepen rregulla të qarta ligjore për disponueshmërinë e rishikimit gjyqësor dhe rregullat procedurale që rregullojnë rishikimin gjyqësor.

18. Mbështetur në rekomandimet e CCJE-së,⁶⁶ gjyqtari objekt vlerësimi duhet të ketë të drejtën të kërkojë zëvendësimin e inspektorit vlerësues, i cili, me objektivitet, mund të perceptohet si i njëanshëm.

19. Gjyqtarët më të mirë dhe me më shumë eksperiencë duhet të inkurajohen të shërbejnë si vlerësues. Për të tërhequr inspektorë të kualifikuar, duhet të merren masat e duhura për ta bërë më atraktiv pozicionin e inspektorit.

20. Megjithëse ka rregulla ligjore për ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve, këto rregulla nuk duket se njihen mirë ndërmjet gjyqtarëve. Këto rregulla mund të trajtohen në arsimin ligjor fillestar të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës.

21. Në ligj duhet të përcaktohen rregulla të qarta ligjore për të bërë dallimin e kompetencave të MD-së dhe të KLD-së lidhur me inspektimin gjyqësor. Në përgjithësi, mund të jetë e preferueshme që të gjitha inspektimet gjyqësore të përqendrohen tek KLD-ja. Megjithatë, proceset disiplinore dhe vlerësimet gjyqësore duhet të mbahen të ndara si lidhur me rregullat e zbatueshme dhe lidhur me personat që i zbatojnë këto rregulla. Përpara se të bihet dakord për një reformë të tillë bazë, KLD-ja dhe MD-ja duhet të kenë të drejtën të nisin procedime disiplinore.

⁶⁶ Opinioni 17 (2014) para. 36 i CCJE-së.